BIBLIOTHECAE 11

Revistë shkencore-kulturore e Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë

BIBLIOTEKONOMI PROJEKTE TË REJA DOKUMENTE
LEXIME TË REKOMANDUARA HISTORI E LIBRIT DHE E SHTYPIT

2010

BIBLIOTHECAE

Revistë kulturore –shkencore e Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë

Nr. 11 Viti 2010

Drejtor
Prof. Dr. Aurel Plasari

Përpunimi grafik
Elzana Agolli

© Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë

Adresa:
Biblioteka Kombëtare
Sheshi «Skënderbe»
Tiranë
Tel. & Fax : + 355 42 223843/257670
www.bksh.al

Shtypur në shtypshkronjën albPAPER

AKTET

E

KONFERENCËS KOMBËTARE

TË

BIBLIOTEKONOMISË

Shkenca e bibliotekave dhe albanologjia

(edicioni V)

22 - 23 nëntor 2010

I përgatitën për botim:

Dr. Etleva Domi
Dr. Ramazan Vozga

Konferenca kombëtare e bibliotekonomisë

Edicioni i pestë i Konferencës Kombëtare të Bibliotekonomisë, si institucion kulturor-shkencor i përbashkët Shqipëri-Kosovë, u mbajt në Tiranë prej datës 22 deri 23 nëntor 2010 nën temën "Shkenca e bibliotekave dhe albanologjia".

Në Konferencë morën pjesë drejtues të bibliotekave kombëtare, publike, universitare etj., specialistë të bibliotekonomisë nga Shqipëria dhe Kosova.

Fjalën e hapjes e mbajti znj. Farfuri Xhaja, specialiste e shquar e shkencës së bibliotekave në Shqipëri. Në emër të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të Shqipërisë përshëndeti zëvendësministrja znj. Suzana Turku.

Konferenca i zhvilloi punimet në disa seksione, me kumtime e diskutime. U mbajtën dy ligjërata: njëra me titull "Ç'e bën *shqiptar* një bibliotekar" nga Prof. Dr. Aurel Plasari, drejtor i Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë, dhe tjetra "Bibliotekat e Kosovës dhe albanologjia" nga Prof. Dr. Sali Bashota, drejtor i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, të cilat u ndoqën me mjaft interes nga të pranishmit. Në kumtesat e specialistëve të të dy bibliotekave u trajtuan probleme që kanë të bëjnë me formimin e specialistëve të burimeve albanologjike, me funksionet albanologjike të bibliotekave tona kombëtare, format e pasurimit dhe/ose zhvillimit të koleksioneve albanologjike në mjedisin digjital, domosdoshmërinë e sistemeve bibliotekare elektronike me burim të hapur etj.

Në seancën plenare të mbylljes së punimeve z. Plasari dhe z. Bashota parashtruan konkluzionet dhe rezultatet e konferencës. Konferenca miratoi rezolutën përkatëse, në të cilën u shpreh besimi se Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë dhe Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës si edhe bibliotekat e tjera në të dy vendet që shërbejnë literaturë albanologjike do të ngrenë në një nivel më të lartë angazhimin për plotësimin si duhet të detyrave në një fushë të rëndësishme si ajo e shërbimeve albanologjike në përmbushje kështu të misionit të tyre të rëndësishëm kombëtar dhe kulturor.

AGENDA

- Ç'e bën *shqiptar* bibliotekarin — 8
  Prof. Dr. Aurel PLASARI
  Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë

- Bibliotekat e Kosovës dhe albanologjia — 14
  Prof. Dr. Sali BASHOTA
  Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

KUMTIME

- Hartografia dhe albanologjia, arritje dhe probleme — 21
  Afërdita SHARRXHI
  Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë

- Bibliotekat Kombëtare – komunikimi albanologjik — 27
  Jehona SHALA
  Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

- Karakteri albanologjik i funksioneve të Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë — 30
  Farfuri XHAJA
  Biblioteka e Universitetit Amerikan, Tiranë

- Zhvillimi i koleksioneve albanologjike në mjedisin digjital — 35
  Etleva DOMI
  Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë

- Koleksionet albanologjike në BKUK 43
  Adil OLLURI, Berat DAKAJ
  Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

- Format e pasurimit dhe reflektimi i tyre në albanologji 46
  Fatime MILLAKU, Besnik GASHI
  Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

- Sistemet bibliotekare me burim të hapur, mundësi për krijimin e burimeve elektronike 53
  Behije LUGA, Enilda KOLA
  Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë

- Bibliografia dhe albanologjia, vështrim historiko-analitik 60
  Suela NDOJA
  Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë

- Bibliotekat e veçanta dhe botimet albanologjike 65
  Flamur Maloku
  Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

DOKUMENTE

- Rezolutë "Shkenca e bibliotekave dhe albanologjia" 73

Ç'e bën *shqiptar* bibliotekarin

Prof. Dr. Aurel PLASARI
Biblioteka Kombëtare
e Shqipërisë

Specialistët e librit, të gjithë punonjësit që merren në mënyrë profesionale me librin, janë universalë për nga formimi, që do të thotë: zotërojnë dije të përgjithshme ose të gjithëmbarshme, por ata pajisen edhe me dije të cilat i lidhin me kulturën e kombit të tyre, në veçanti me kulturën e shkruar e të botuar të kombit të tyre. Për këtë arsye tema e kësaj konference, *Shkenca e bibliotekave dhe albanologjia*, ka synuar të përqendrohet në një pikëpërpje që do ta cilësoja jetike për profesionalitetin e një bibliotekari shqiptar.

Kolegët të cilët këtë vit, gjatë studimeve për Masterin e Nivelit të Dytë në Shkencën e Bibliotekave, kanë pasur rastin të ndjekin leksionet e lëndës *Hyrje në albanologji* e kanë vënë re se gjatë programimit të tij lëndën në fjalë e kemi konsideruar si themelore ndër lëndët e formimit të përgjithshëm të specialistëve tanë të librit. Ta themi më thjesht dhe më shqip: ishte lënda që e bën shqiptar një specialist të librit. E bën shqiptar në kuptimin profesional, jo në kuptimin e analizave të tjera bio-fiziologjike. Pikërisht prandaj përgatitja albanologjike, qoftë edhe në masën e një "Hyrjeje" të tillë, duhet të bëhet e detyrueshme për specialistët shqiptarë të librit në formimin e tyre profesional.

Është e vërtetë se lënda që e quajtëm *Hyrje në albanologji* nuk ka as në kulturën shqiptare dhe as në shkencat shqiptare një traditë të stabilizuar të trajtimit të saj. Duke qenë se jemi të gjithë specialistë të librit, në mënyrë më të thjeshtë e më konkrete le ta themi që nuk ka për të një tekst bazë, të mirëfilltë, që të trajtojë së paku "hyrjen" në atë grup dijesh që i quajmë *albanologjike*. Ka disa

tekste, që numërohen me gishtat e njërës dorë dhe që mbajnë tituj përafërsisht të tillë. Por, nëse shqyrtojmë brendinë e tyre, kuptohet lehtë që përmbajtja është diçka e ndryshme nga ajo që titujt në fjalë premtojnë: këtë, për shembull, do ta dallonin menjëherë ata mes jush që janë klasifikatorë për nga specialiteti në shkencën e bibliotekave.

Dy tekstet më të rëndësishme ndër këta tituj janë *Histori e albanologjisë* e autorit Jup Kastrati dhe një tjetër po *Histori e albanologjisë*, pra me të njëjtin titull, e autorit Xheladin Gosturani. T'i këqyrim së bashku për të dalluar se *sa* dhe *si* mund të na shërbejnë.

Tekstin *Histori e Albanologjisë* autori Jup Kastrati e ka planifikuar për hapësirën kohore 1497-1997. Vëllimi i parë, pra ky i botuari, përfshin vitet 1497-1853. Ja treguesi i lëndës simbas krerëve përkatës: Kreu I: Periudha *parashkencore e studimit të gjuhës shqipe (1497-1853)*; Kreu II: *Gjuha shqipe në shek. XIII, XIV, XV*; Kreu III: *Fillimi i studimit të gjuhës shqipe shekulli XV-XVI*; Kreu IV: *Studimet për gjuhën shqipe në shekullin XVII*; Kreu V: *Gjuhësia shqiptare në gjysmën e parë të shekullit XVIII*; Kreu VI: *Puna e dijetarëve vendës për gjuhën shqipe në gjysmën e dytë të shek. XVIII*; Kreu VII: *Lëvizja mendore gjuhësore e një mjedisi arbëresh të Italisë në gjysmën e dytë të shekullit XVIII*; Kreu VIII: *Studiues të huaj për gjuhën shqipe në gjysmën e dytë të shekullit XVIII*; Kreu IX: *Studimet shqiptare në fushën e gjuhësisë në fillim të shekullit XIX në Greqi*; Kreu X: *Përpjekjet e dijetarëve tanë në Shqipëri për studimin e gjuhës shqipe në gjysmën e parë të shekullit XIX (1801-1850)*; Kreu XI: *Gjuhësia shqiptare në gjysmën e parë të shekullit XIX ndër arbëreshët e Italisë*; Kreu XII: *Zgjimi i interesit shkencor për popullin shqiptar dhe për gjuhën shqipe midis dijetarëve të Evropës Perëndimore në gjysmën e parë të shekullit XIX*; Kreu XIII: *Studiues italianë, francezë, austriakë, gjermanë, serbë, rumunë, danezë, grekë për gjuhën shqipe në gjysmën e parë të shekullit XIX (vitet 1809-1849)*; Kreu XIV: *Studime për përcaktimin e lidhjeve gjuhësore të shqipes me gjuhët e tjera dhe analiza krahasimtare e fakteve të gjuhës shqipe*. Kaq.

Tanimë cilido klasifikator, edhe ai më modesti, do ta kuptonte që është fjala për një histori të gjuhësisë shqiptare ose, të themi kështu, një përsëritje e zgjeruar dhe e shtjelluar e një libri të dikurshëm të autorit Jup Kastrati me titull *Historia e gramatologjisë së gjuhës shqipe*, një informacion me vlerë, pa pikë dyshimi, por i kufizuar vetëm në një disiplinë: në atë të gjuhësisë. Kur një tekst i këtillë mëvishet me titullin *Histori e albanologjisë* tërthorazi mund të na bëjë të pandehim se albanologjia nuk qenkësh tjetër veçse studimi i gjuhës ose gjuhësia në hipostazat e ndryshme të saj. Kjo shkencërisht nuk rezulton aspak e vërtetë. Shkurt: pavarësisht titullit në fjalë, teksti i autorit Kastrati nuk përfaqëson as një *Histori të albanologjisë*, as një *Hyrje në albanologji*, por një *Histori të gramatologjisë shqipe* ose *Histori të gjuhësisë shqipe*. Fundja, nuk na takon këtu ta përsaktësojmë.

Një skemë përafërsisht të njëjtë

ka shtënë në punë edhe autori Xheladin Gosturani në *Histori e albanologjisë*: edhe ky, ndonëse me një tjetër metodë, nuk ka realizuar veçse një histori të gjuhësisë shqipe ose diçka që gjithsesi lidhet me historinë e studimit të gjuhës shqipe dhe jo një "histori të albanologjisë", ndoshta i ndikuar - për titullin - nga titulli që i ka vënë tekstit paraardhësi Kastrati.

Si specialistë të librit ne kemi një avantazh ndaj hulumtuesve dhe studiuesve: avantazhin jo vetëm për të vënë të dyshim ato që nuk na bindin, por për t'i kontrolluar punët *de manu*, d.m.th. duke i "prekur me dorë", për t'i verifikuar ato dhe, si rrjedhojë, edhe për të zbuluar situata të reja.

Të shqyrtojmë atëherë një dispensë shumë të vjetër, të nxjerrë nga fondi "Arkiv" i BKSh: titullin e ka *Albanologji* dhe është botim i Institutit Pedagogjik i vitit 1947. Paraqitet tekst i shaptilografuar, pra duhet të ketë pasur qarkullim të kufizuar, të ngushtë. "Titulli" *Albanologji* është shkruar me dorë, pra nga dikush që i ka lidhur fletët pikërisht në formë dispense, jo nga daktiloshkruesi në letra të dyllit dhe, pra, as nga autori. Specialistët e librit i dinë këto mospërputhje "të vogla" mes titujve dhe përmbajtjeve, që ndodhin rëndom nëpër dispensa ose tekste të shaptilografuara, të daktiloshkruara etj., por që mund të shkaktojnë keqkuptime me rëndësi tek ata që nuk i "prekin me dorë". Të sqarojmë tani që teksti në fjalë, i 1947-s, është i autorit Eqrem Çabej dhe në fletën e përmbajtjes gjejmë titullin e vërtetë të dispensës: Çabej nuk e paskësh titulluar aspak *Albanologji*, siç është shkruar me dorë në kopertinë, por *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe*. Që titulli është ky vërtetohet edhe nga vetë përmbajtja.

Ka shumë mundësi, pra, që ata që janë marrë me historinë e albanologjisë, gjatë punës praktike, të jenë ngatërruar nga kjo emërtesë e një dispense të vjetër në një kopertinë të improvizuar: d.m.th. që emërtesa *albanologji* t'i mëvishet një teksti që nuk trajton veçse *historinë e gjuhës shqipe*. Shumë vite më vonë tekstit të kësaj dispense i është bërë një ribotim, tanimë në formë libri: ja tek e kemi këtu. Dhe tanimë është titulluar ashtu sikurse e ka pasë caktuar vetë autori Eqrem Çabej: *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe*. Botuesja Çabej, që ka përgatitur këtë botim të ri, na ka saktësuar edhe faktin historik që teksti me titullin *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe* lidhet pikërisht me tekstin e shaptilografuar të 1947-s.

Ja pra, si pjesë e kërshërisë sonë profesionale, ky rast që na ndihmon të shpjegohet situata "e sikletshme" lidhur me mungesën e teksteve bazë të një lënde si *Hyrje në albanologji* dhe rrezikun e ngatërrimit me tekste të kështuquajtura "Histori të albanologjisë".

Në më lejoni që kjo fjalë imja të shërbejë si rekomandim leximesh për përgatitje dhe formim të shkallë-shkallshëm në këtë perspektivë, atëherë do të saktësoj sa më poshtë:

Çështja e parë që trajtohet në hyrjen e çdo shkence ose dijeje, si në shkollën e mesme ashtu edhe në nivelet universitar, mbasuniversitar etj., është ajo e përcaktimit të objektit: këtë e quajmë që e dimë të gjithë. Dhe vetëm mandej flitet për historinë e shkencës ose dijes

në fjalë: si ka lindur ajo, stadet nëpër të cilat ka kaluar ose shkallët që ka ngjitur e ka zbritur, marrëdhëniet që ka vendosur me shkencat me të cilat ka marrë e ka dhënë. Është prirje e përgjithshme e prurë nga filozofia për të pohuar se çdo shkencë lypset të përcaktojë pikësëpari objektin e saj. Por pikërisht këtu do të bëj një objeksion për ç'i përket çështjes së objektit të një shkence, pra jo vetëm dhe thjesht të albanologjisë.

Prirjen e përgjithshme, të prurë nga filozofia, për të pohuar se çdo shkencë përcaktohet/përkufizohet nëpërmjet objektit të vet do ta quaj shumë relative, për të mos thënë të pabazë, për shkakun e thjeshtë sepse në gjithë veprimtarinë tonë njerëzore nuk ekziston asnjë shkencë (asnjë dije) që të ketë një objekt *të caktuar*. Gjithë sa formon objektin e hulumtimeve dhe studimeve tona është realiteti dhe ky realitet – i njëjti realitet – hulumtohet dhe studiohet në të gjitha operacionet e mendjes sonë, jo vetëm në ato shkencore, por edhe në ato filozofike. Në këtë kuptim mendoj se në asnjë shkencë – fizikë, kimi, matematikë, psikologji, estetikë etj. – nuk ekziston një objekt që të përkufizojë/përcaktojë fushën e caktuar të shkencës në fjalë: ta "përkufizojë" d.m.th. t'i vërë kufij, sikurse ta "përcaktojë" d.m.th. t'i vërë caqe. Çdo shkencë ka të bëjë me tërë realitetin, me fjalë të tjera: fusha e veprimtarisë së gjithë shkencës ose fusha që ka të bëjë me objektin e çdo shkence është tërë realiteti. Mbi këtë realitet mendja njerëzore mund të hedhë gjithfarë vështrimesh. D.m.th. mendja jonë mund të drejtohet ndaj një perspektive ose ndaj një tjetre dhe çdonjëra prej këtyre perspektivave përfaqëson, për ne, fushën e një shkence ose të një dijeje. Si rrjedhojë, ajo çfarë përkufizon/përcakton fushën e një shkence nuk është objekti i saj dhe as nuk janë *objektet* që ne hulumtojmë dhe studiojmë në atë shkencë, por janë *aspektet* në të cilat ne, në çdonjërën prej shkencave, vështrojmë realitetin. Kështu kemi aspektin fizik të realitetit, aspektin e tij kimik, aspektin e tij matematik, atë logjik etj., por nuk kemi një realitet fizik, kimik, matematik ose logjik. Me fjalë të tjera: realiteti është, i tillë siç paraqitet, një i tërë brenda të cilit ne nuk presim me thikë fusha ngastra-ngastra, por thjesht krijojmë perspektiva mbi to. Në këtë kuptim nuk do të mund të flitej për *objektin* e një shkence, por shumë-shumë për *temat* që një shkence i duhet të zgjedhë në lidhje me realitetin. Ky objeksion do të ketë rëndësi të veçantë për atë që mund të quhej "objekt" i albanologjisë dhe që, siç do ta shohim, përbën më së shumti pikërisht një "tërësi" temash me të cilat albanologët janë marrë dhe merren lidhur me atë realitet që po e quaj "bota shqiptare" në kuptim përgjithësues.

Të vështrojmë tani se si e përkufizon termin/konceptin "Albanologji" *Fjalori Enciklopedik Shqiptar* (1986): "**Tërësia e studimeve që kanë bërë dhe bëjnë studiuesit e huaj për historinë, gjuhën dhe kulturën e popullit shqiptar...**". Pra, të paktën ka mbledhur tri disiplina ose tri shkenca të rëndësishme përfaqësimtare: histori, gjuhësi dhe kulturë. Në të vërtetë, kultura - ju e keni parasysh - është korpus tejmasë i gjerë, ku përfshihen disiplina të larmishme. Kështu edhe vetë *Fjalori* na

bind që dy veprat që përmenda, që merren me historinë e gjuhës dhe të gjuhësisë, nuk e përmbushin dot kushtin e historisë së një shkence siç qenkësh albanologjia.

Shikoni edhe këtë shtesë të dytë të përkufizimit, sepse edhe kjo është e rëndësishme: "**Ky term është përdorur gjithashtu edhe për studimet e kryera në këto fusha nga studiuesit shqiptarë**". Dallojmë, pra, faktin që kultura, trashëgimia kulturore e një populli në përgjithësi, - përfshi historinë e tij, gjeografinë, gjuhën, doket etj., - siç hulumtohen nga studiuesit e huaj, u hulumtuakan edhe nga studiues të vetë atij populli. (Sa për saktësim: nuk di të them në ndodh kështu edhe me shkenca simetrike, siç janë sllavistika, gjermanistika, romanistika, turkologjia etj.) Realiteti shqiptar si objekt hulumtimi paskësh prodhuar një dukuri më shumë: që shkallë-shkallë termi *albanologji* është përdorur dhe për hulumtime/studime të kryera nga studiues shqiptarë. Në rast se në pjesën e parë të përkufizimit kemi të bëjmë me një Hahn, një Gustav Meyer, një Jokl, një Tagliavin etj., në pjesën e dytë të tij kemi të bëjmë me instancë më shumë: edhe studiues shqiptarë, të themi si Çabej, marrin ose është bërë traditë që të marrin këtë emërtim. Vetëm se, pavarësisht kësaj situate, nuk mund të mohohet një specifikë: që është pjesa e parë e këtij përkufizimi ajo që mbetet e rëndësishmja për ne, është ajo që e bën albanologjinë *albanologji*.

Duke pasur parasysh këtë specifikë mendoj se mund ta mbyll këtë ligjëratë duke përfunduar me një përkufizim sa më të plotë të mundshëm të albanologjisë:

Me albanologji kuptojmë një tërësi disiplinash të ndryshme dhe heterogjene (këtu ndryshojmë nga *Fjalori Enciklopedik*), pjesë të shkencave humane sociale, por pjesërisht edhe natyrore (sepse jemi në një epokë tjetër, epokë moderne), - histori, arkeologji, gjeografi, gjuhësi, etnologji, antropologji (nënkuptohet edhe fizike edhe kulturore), demografi (mos e harrojmë këtë), histori dhe teori e së drejtës, shkencë e letërsisë, ekonomi, politologji (studime shumë të zhvilluara sot në bashkëkohësi) etj. – që kanë për objekt studimi gjithë sa ka të bëjë me kulturën humane të shqiptarëve (humane në kuptimin që lidhet me jetën njerëzore), historinë e tyre, realizimet e tyre, mënyrën e tyre të jetesës dhe të sjellët e tyre si individë e si shoqëri, prodhimtarinë e tyre shpirtërore në marrëdhënie e rrafsh krahasimtar me fqinjët dhe bashkësitë më të mëdha, të cilave ata u kanë përkitur dhe/ose u përkasin (që nënkutohet rajoni dhe Europa).

Por ç'gjejmë në këtë përkufizim? Asgjë tjetër përveçse realitetit tonë *libror* me të cilin jemi të rrethuar çdo ditë dhe brenda të cilit punojmë e funksionojmë. Atë realitet libror që kushtëzon vetë ekzistimin tonë si specialistë të bibliotekave, të cilat Ndoc Nikaj, këtu e një shekull të shkuar, i thërriste shqip "libërtore". Do të na mjaftonte të mbajmë në objektiv të vëmendjes sonë mbarë këtë sferë interesash informativë e studimorë që përfshin *albanologjia* dhe atëherë nuk do ta kishim të vështirë të përparojmë hap mbas hapi në përgatitjen që lakmojmë.

Pavarësisht mungesës së një teksti bazë për lëndën në fjalë, studimet për historinë e albanologjisë, si edhe për problemet e saj nga më të larmishmet, nuk mungojnë. Madje ato kanë ardhur duke u bërë të shumta dhe gjithnjë më profesionale sidomos prej pjesës së dytë të shekullit të kaluar, d.m.th. atij XX. Them "sidomos", çfarë nënkupton që nuk përjashtohet që edhe në pjesën e parë të shek. XX studime për historinë e albanologjisë dhe për problemet e saj të kenë ekzistuar. Por tezat me të rëndësishme në këto studime regjistrohen padyshim në gjysmën e dytë të shek. XX. Është fjala për materiale me vlerë, që çdo specialist i librit do të duhet t'i kalojë për duarsh: t'i diskutojë, të debatojë për to, t'u shtojë atyre informacione të tjera, si dhe të pyesë për të përmbushur kureshtjen profesionale. Ndër to edhe dy tekstet që u përmendën, *Histori e albanologjisë* e autorit Jup Kastrati dhe *Histori e albanologjisë* e autorit Xheladin Gosturani, do të na jenë me vlerë për ç'i takon asaj fushe të albanologjisë që është studimi i gjuhës shqipe.

Profesioni ynë, si specialistë të librit, parakupton mundësi të privilegjuara për të thelluar dhe zgjeruar dijet në këtë pikëprerje: të *shkencës së bibliotekave* me *albanologjinë*. Nga ana tjetër, po profesioni që kemi na krijon mundësi që nuk i ka gjithkush për të zhvilluar tema nga më të larmishmet duke u përqendruar po te kjo pikëprerje dy shkencash. Të mos e harrojmë, pra, këtë specifikë të pozicioneve tona profesionale me mundësitë që na hap ajo, sidomos, me faktin më të rëndësishëm për ne: se pa këtë specifikë emërtimin *bibliotekarë shqiptarë* nuk do ta meritonim.

Bibliotekat e Kosovës dhe albanologjia

Prof. Dr. Sali BASHOTA
Biblioteka Kombëtare
dhe Universitare e Kosovës

Hyrje

Në faza dhe periudha të caktuara historike e shoqërore, identiteti kulturor i Kosovës, ndër të tjera, ndërlidhet edhe me çështjen e albanologjisë. Prandaj, nga mungesa e institucioneve, intelektualët shqiptarë të Kosovës e kanë kryer misionin e tyre në shumë fusha.

Në shekullin XVII njihet kontributi i Pjetër Bogdanit me veprat e tij, të cilat janë dëshmi e fuqishme për bazat e humanistikës shqiptare edhe në planin ndërkombëtar. Po kështu, në fushën e shkencës, të traditës dhe të kulturës shqiptare shquhej Shtjefën Gjeçovi.

Në vitet dyzet të shekullit të kaluar, në Kosovë, u hapën institucionet e para kulturore e edukative. Në Prizren u themelua Qendra e Vogël për Studime Kosovare në krye me albanologun Selman Riza, e cila kishte për synim kryesor studimet në fushën e albanologjisë.

Në dhjetor të vitit 1944, në Prizren, themelohet institucioni i parë bibliotekar, që sot është Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës; ndërkaq, në vitin 1953, në Prishtinë, themelohet Instituti Albanologjik i Prishtinës.

Drejtimet e para me karakter studimor albanologjik u themeluan në kuadër të Shkollës së Lartë Pedagogjike të Prishtinës në vitin 1958, ndërsa Katedra

e Albanologjisë u hap në vitin 1960 në Fakultetin Filozofik të Prishtinës.

Faktet dhe dëshmitë për zhvillimin e një aktiviteti më të përqendruar në fushën e albanologjisë kanë të bëjnë edhe me organizimin e Konsultës Gjuhësore të Prishtinës në vitin 1968 dhe sidomos me Kongresin e Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe që u mbajt në vitin 1972 në Tiranë.

Themelimi i këtyre institucioneve dhe organizimi i këtyre aktiviteteve, gjithsesi, kanë kontribuar në zhvillimin dhe afirmimin e çështjes së albanologjisë.

Veprimtaria botuese

Veprimtaria botuese në gjuhën shqipe në Kosovë ka filluar në vitet '40 të shekullit XX. Që nga viti 1943 fillojnë të botohen broshura të ndryshme në gjuhën shqipe. Libri i parë i Leximit botohet në vitin 1945, ndërsa "Abetarja" e parë në vitin 1946. Në vitin 1950 themelohet Shtëpia Botuese "Mustafa Bakija", e cila në fillim të veprimtarisë së saj botonte vepra të përkthyera e pastaj edhe vepra origjinale. Në këtë periudhë fillojnë të botohen vepra të autorëve të Kosovës, ndërsa nxitja, përkrahja dhe afirmimi i krijuesve përqendrohet sidomos pas themelimit të revistës letrare "Jeta e re" në vitin 1949, e udhëhequr nga Esad Mekuli. Kjo revistë e kishte rolin dhe misionin e saj të rëndësishëm në përkrahjen e krijuesve dhe në zhvillimin e përgjithshëm të letërsisë dhe kulturës shqipe në Kosovë.

Aktiviteti i Shtëpisë Botuese "Mustafa Bakija" integrohet në vitin 1958 në kuadër të shtypshkronjës dhe të Ndërmarrjes Botuese Grafike "Rilindja", me veprimtarinë e saj të gjithanshme në shumë fusha; gjithsesi, bëhet edhe botuesi kryesor i veprave origjinale dhe të përkthyera, botuesi kryesor i librit shqip dhe promovuesi kulturor i botimit të veprave të Eqrem Çabejt në Prishtinë.

Veprimtaria botuese e teksteve shkollore përqendrohet tek "Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore"(botuesi i sotëm "Libri Shkollor"), që është themeluar në vitin 1970.

Redaksia e botimeve "Rilindja", e cila botoi mbi 2000 vepra të autorëve shqiptarë, i ka afirmuar vlerat kulturore, shkencore, letrare jo vetëm në Kosovë, por edhe më gjerë. Shifra dhe fakte dëshmojnë se deri në vitin 1989, "Rilindja" i kishte botuar mbi 3800 tituj veprash të ndryshme. Një pjesë e madhe e veprave i përkisnin fushës së albanologjisë. "Rilindja" u bë njëri ndër botuesit më të mëdhenj në rajon, madje edhe me tirazhin e veprave të botuara, duke e afirmuar kulturën dhe letërsinë shqipe në panairet kombëtare dhe ndërkombëtare. Nga vëllimi i madh i botimeve në këtë periudhë, në vitin 1985 Kosova kishte një libër për kokë të banorit.

Veprimtarinë botuese me karakter kërkimor dhe shkencor në fushën e albanologjisë ,e kanë zhvilluar dhe e

zhvillojnë edhe Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, e cila nga viti 1976 deri në vitin 2010 i ka botuar mbi 200 tituj veprash të ndryshme nga fusha e gjuhësisë, letërsisë, arteve; ndërkaq Instituti Albanologjik i Prishtinës, prej fillimit të veprimtarisë botuese e deri në vitin 2010 i ka botuar mbi 400 tituj veprash nga fushat e albanologjisë: gjuhësi, letërsi, folklor, histori dhe etnologji.

Edhe institucionet e tjera arsimore, shkencore, kulturore, siç janë: Universiteti i Prishtinës, Arkivi i Kosovës, Instituti i Historisë e botues të tjerë e kanë zhvilluar dhe vazhdojnë me veprimtarinë botuese në fushat e tyre hulumtuese, shkencore, profesionale, ndërkaq revistat shkencore "Gjurmime Albanologjike" (Instituti Albanologjik i Prishtinës), "Studime" (Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës) dhe "Filologji" (Fakulteti i Filologjisë) e kanë pasuruar fondin e studimeve albanologjike në shumë drejtime.

Veprimtaria botuese në Kosovë është zhvilluar edhe në institucione të tjera kulturore e shkencore të Kosovës, por edhe nga asociacionet private.

Fondi i librit shqip dhe koleksioni i albanologjisë

Albanologjia, si fushë e shkencës që merret me studimin e historisë së shqiptarëve, të gjuhës shqipe dhe të letërsisë e të kulturës shqiptare, në Kosovë është perceptuar në radhë të parë si edukim, si identitet shqiptar, si mbrojtje e lirisë njerëzore dhe e lirisë kombëtare.

Në këtë drejtim edhe rrjeti i bibliotekave me koleksione albanologjike në Kosovë është i përqendruar kryesisht në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, Institutin Albanologjik të Prishtinës, Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, Bibliotekën e Fakultetit të Filologjisë, si dhe në disa institucione të tjera.

Me rrënimin e pozitës kushtetuese të Kosovës në vitin 1989, veprimtaria bibliotekare, sikundër edhe në sferat e tjera në kulturë, arsim e shkencë, u diskriminua nga pushteti serb. Periudha e viteve 1998-1999 është periudha e okupimit dhe e inkuizicionit, pra e shkatërrimit, zhdukjes dhe e djegies së koleksioneve bibliotekare në gjuhën shqipe në shumë biblioteka publike dhe private në Kosovë.

Nga viti 1990 deri në vitin 1999 në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës pushteti okupues serb aplikoi masat e dhunshme dhe u mohohej e drejta lexuesve shqiptarë për shërbime.

Gjithashtu, në periudhën e administrimit serb, Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës i janë shtuar 22.000 libra, të gjitha në gjuhën serbe dhe asnjë në gjuhën shqipe, ndërsa po në këtë periudhë 100.000 libra në gjuhën shqipe, të cilat kanë qenë të destinuara për shkëmbim dhe dhurim, janë zhdukur nga administrata e dhunshme e këtij institucioni. Po kështu, në këtë institucion është një bërë edhe një spastrim i madh i koleksioneve me vlerë kombëtare,

sidomos veprat e autorëve të traditës shqipe dhe të atyre që i takonin fushës së albanologjisë.

Në bibliotekat publike dhe private në Kosovë janë zhdukur dhe djegur me mijëra koleksione bibliotekare. Sipas burimeve vendore dhe ndërkombëtare, vetëm në 175 biblioteka në Kosovë në periudhën e viteve 1998-1999 janë shkatërruar dhe djegur nga forcat ushtarake dhe paramilitare serbe 175 biblioteka me një fond prej 1.655.496 ekzemplarësh.

Pra, libri dhe bibliotekat në Kosovë kanë kaluar nëpër periudha të ndryshme të zhvillimit dhe të ndërprerjes. Faktet dhe dëshmitë tregojnë për fazat e zhvillimit dhe të afirmimit normal të veprimtarisë botuese dhe bibliotekare, por edhe për fazat e diskriminimit dhe të okupimit, duke filluar sidomos nga vitet '80 të shekullit XX e deri në vitin 1999.

Fondi i studimeve filologjike, historike, trashëgimisë popullore shqiptare, kulturës shqiptare, në njërën anë, dhe koleksionet shumëgjuhësore dhe shumëkulturore, kryesisht me burim sllav dhe në rrethana të caktuara politike, në anën tjetër, kanë qenë në "grindje" dhe në përballje të vazhdueshme, sidomos në gjysmën e dytë të shekullit XX. Mirëpo, koleksionet albanologjike të dhuruara nga Shqipëria, gjithsesi, i kanë dhënë frymë kombëtare fondit bibliotekar në bibliotekat e ndryshme të Kosovës. Plot gjysmë shekulli fondi albanologjik nëpër biblioteka të ndryshme të Kosovës është tkurrur apo është strehuar në kuadrin e një fondi librash e materialesh të tjera bibliotekare të dominuara nga gjuhët sllave në ish-Jugosllavi.

Vetëm në periudhën e viteve 1974-1980 ka mbretëruar një liberalizim në fushën e botimeve të veprave në gjuhën shqipe dhe të zhvillimit të veprimtarisë së bibliotekave. Në këtë drejtim Ndërmarrja botuese "Rilindja", duke i botuar për herë të parë veprat e Eqrem Çabejt në Kosovë, si dhe veprat e autorëve të traditës: Naimit, Samiut, Çajupit, Asdrenit, Lasgushit, Mjedjes etj., si dhe veprat e Ismail Kadaresë e të autorëve të tjerë nga Shqipëria, ndër të tjera, ka arritur të krijojë një ndjeshmëri të re kombëtare dhe kulturore për lexuesin shqiptar të Kosovës.

Digjitimi i koleksioneve albanologjike

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës fondin e saj albanologjik e ka të sistemuar në kuadër të Departamentit të Koleksioneve të Veçanta. Libri i rrallë dhe i vjetër, dorëshkrimet, periodiku i rrallë dhe i vjetër, koleksioni i hartave, koleksioni i bibliotekave legatë, letërkëmbimet si dhe koleksionet e tjera të grumbulluara në periudha të ndryshme kohore të sistemuara në kuadër të fondit të përgjithshëm librar, paraqesin vlera për pasurimin dhe zhvillimin e koleksioneve në gjuhën shqipe, por gjithsesi edhe për albanologjinë.

Po i marrim vetëm dy shembuj.

E para: Në koleksionin e librit të vjetër dhe të rrallë në BKUK janë mbi 2500

titul. Prej tyre në katalogun elektronik janë mbi 1100, ndërsa në katalogun manual janë 1430. Në koleksionin e periodikut të vjetër dhe të rrallë janë 225 titul me 2670 njësi, ndërsa të punuara në katalogun elektronik janë 55 titul me 670 njësi; në katalogun manual janë 170 titul me 2000 njësi.

Po kështu, Biblioteka legatë e Krist Malokit, e cila i ka gjithsej 444 titul, prej tyre 397 libra dhe 47 titul të periodikut të vjetër me tërë fondet e saj është në katalogun elektronik. Pjesa më e madhe e këtij koleksioni ka të bëjë me albanologjinë, pra me studimin e gjuhës, letërsisë, historisë së shqiptarëve, kulturës popullore etj.

E dyta: Fondi tjetër i BKUK-së në katalogun elektronik , i cili ndërlidhet me koleksionin e librit shqip dhe të albanologjisë dhe që i përket periudhave më të vonshme, sipas të dhënave më të reja është: 7031 njësi bibliografike të letërsisë shqipe, 1046 të gjuhës shqipe, 518 të historisë shqiptare; gjithashtu, 3655 njësi bibliografike me temë për historinë në përgjithësi.

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës duhet të jetë pikë referimi sa i përket koleksioneve që lidhen me albanologjinë tradicionale, por edhe me albanologjinë bashkëkohore edhe sa i përket përpunimit elektronik të njësive bibliografike dhe digjitimit të tyre. Në këtë drejtim kontributet shkencore të albanologëve të huaj dhe të albanologëve shqiptarë kanë rëndësi të veçantë për studimin e kulturës shpirtërore e materiale të shqiptarëve, sidomos kur ofrohet qasja e lirë nga portalet e institucioneve publike kërkimore dhe shkencore.

Grumbullimi, sistemimi, përpunimi, digjitimi i fondit albanologjik brenda një portali, me pjesëmarrje të institucioneve përkatëse në Shqipëri, Kosovë, në trevat shqiptare, në kolonitë shqiptare në periudhën e Rilindjes Kombëtare, tek arbëreshët e Italisë, diasporën e sotme të shqiptarëve, duke përfshirë edhe raritetet e shumta dhe të ndryshme që kanë të bëjnë me shqiptarët, të ndodhura në biblioteka të ndryshme në botë, mund të realizohen në kuadrin e një projekti të madh kombëtar.

Gjithsesi, Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë në bashkëpunim me institucione kulturore e shkencore të Shqipërisë, si dhe Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës në bashkëpunim me institucione kulturore e shkencore të Kosovës, do të mund kontribuonin në realizimin e këtij projekti për shkencën e albanologjisë, ndërlidhur me studimin e historisë së shqiptarëve, të gjuhës shqipe dhe të letërsisë e të kulturës shqiptare nga vetë shqiptarët dhe nga të tjerët.

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës e ka krijuar koleksionin dokumentar *Kujtesa e Kosovës*, që ka të bëjë edhe me fondin e librit shqip dhe

të huaj që flet për shqiptarët, gjuhën, historinë, kulturën, letërsinë e tyre etj.; ndërsa Bibliotekën Kombëtare e Shqipërisë e ka krijuar portalin *Albanica* që përfaqëson Bibliotekën Digjitale Albanologjike. Më në fund, bibliotekat shqiptare, shkenca e bibliotekave dhe albanologjia, gjithsesi,edhe një kohë do të përballen midis konceptit vetëdije kulturore apo vetëdije shtetërore.

- Hartografia dhe albanologjia, arritje dhe probleme 21
- Bibliotekat Kombëtare – komunikimi albanologjik 27
- Karakteri albanologjik i funksioneve të Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë 30
- Zhvillimi i koleksioneve albanologjike në mjedisin digjital 35
- Koleksionet albanologjike në BKUK 43
- Format e pasurimit dhe reflektimi i tyre në albanologji 46
- Sistemet bibliotekare me burim të hapur, mundësi për krijimin e burimeve elektronike 53
- Bibliografia dhe albanologjia, vështrim historiko-analitik 60
- Bibliotekat e veçanta dhe botimet albanologjike 65

Hartografia dhe albanologjia, arritje dhe probleme

Afërdita SHARRXHI
Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë

Të gjithë duhet të shqetësohemi e të punojmë fort për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e këtij koleksioni me vlera për kombin tonë. Eksperienca botërore dhe burimet njerëzore nuk mungojnë, por, duhen gjetur mjetet financiare që do të mundësojnë digjitimin e hartave dhe hedhjen e imazheve kompiuterike të tyre në Internet.

Vlerat e hartave albanologjike

Hartografia i ka rrënjët e saj që në lashtësi dhe është zhvilluar bashkë me zhvillimin e shoqërisë. Si çdo shkencë tjetër, hartografia ka pasqyruar nivelin e zhvillimit shoqëror, ekonomik, teknik etj. të kësaj shoqërie. Ka ndjekur hap pas hapi ngjarjet historike dhe politike, ndryshimet ekonomiko-shoqërore, etnografike, demografike dhe lëvizjet e popullsisë përgjatë historisë. Historia e hartografisë tregon se kufijtë kanë ndryshuar në funksion të ngjarjeve politike e historike të një vendi apo kombi. Dëshmia më e qartë janë ndryshimet e herëpashershme që kanë pësuar historikisht trojet shqiptare, të hartografuara në një numër të madh hartash të Europës Juglindore, të përpiluara nga autorë të ndryshëm nga antikiteti deri në kohët më të reja. Pozita gjeografike dhe strategjike, zhvillimi i tregtisë, marrëdhëniet tregtare me fqinjët e më gjerë, burimet natyrore, luftërat e pandërprera që janë zhvilluar në truallin tonë janë disa nga arsyet e hartografimit të trojeve shqiptare përgjatë historisë. Hartografia, si dhe shkencat e tjera (historia, gjeografia, sociologjia, etnografia, antropologjia etj.), është e lidhur ngushtësitë me albanologjinë.

Përpjekjet e para të mirëfillta të hartografimit të trojeve tona i gjejmë që në antikitet, me hartën e botës së Ptolemeut, në veprën e tij madhore

"Gjeografia", që është botuar e ribotuar disa herë. Biblioteka Kombëtare ruan, në koleksionin e veprave të rralla, botimet e vitit 1564 dhe 1620-1621 në italisht, me 26 harta, të kësaj vepre me interes për historinë, për gjeografinë dhe për toponiminë e qyteteve shqiptare, si: Durrës (Epidamnus), Apoloni, Vlorë (Aulona), Sazan, Orikum, Lezhë (Lissus), Elbasan (Scampi), Berat (Antipatrea), Ohër (Lychnidus), Prishtinë (Ulpiana), Prizren (Thermidava), Pejë (Siparantum), Podujevë (Vendenis) etj., dhe të një numri vendbanimesh, hidronimesh e oronimesh të tjera me emërtimet e tyre të vjetra. Mbi hartën e Ptolemeut u mbështetën një plejadë e tërë hartografësh në shekujt e mëvonshëm, që paraqitën brendësinë e Gadishullit Ballkanik, brigjet e Adriatikut dhe të Mesdheut Lindor, përfshirë edhe trojet tona. Në shekullin XV, para dhe pas shpikjes së shtypshkronjës së Gutenbergut, ekzistonin vetëm disa harta lundrimi, toponimet e të cilave për vendin tonë, siç pohon Ermano Armao, janë në një numër mjaft të pakët. Në shekujt XVI - XIX, shtohet numri i hartave që paraqesin Gadishullin Ballkanik. Territoret shqiptare paraqiten përgjithësisht nën emërtimet "Illyria", "Albania", "Albanie", "Albanien", "Epirus", "Basse Albanie", "Haute Albanie", "Podrimia Provincia", "Dardania", Illyris etj. Hartat e përpiluara nga Giovanni Gastaldi, Giovannni Francesco Camozio, Nikolaos Sophiani, Abraham Ortelius, i njohur për atlasin e tij "Theatrum Orbis terrarum", botuar për herë të parë në vitin 1570 dhe ribotuar disa herë më vonë (botimi italisht i vitit 1667 gjendet në Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë), Giacommo Cantelli, Vincenzo Maria Coronelli, Gerard Mercator, Frederik Wit, Guillaume dhe Nicolas Sanson, Guillaume Delisle, Jean Baptiste Danville, Alexis-Hubert Jaillot, Johan Homann dhe bijtë e tij, Johann Lauremberg, Tobias Lotter, Antonio Zatta, Pierre Lapie, Heinrich Kiepert, Hahn etj., sjellin informacione me vlerë për territorin shqiptar dhe vendbanimet e tij. Dukat qartë se në këto harta toponimet janë të shumta dhe emërtimet e tyre më të sakta, veçojmë hartën e Coronelli-t "*Rjedha e lumenjve Drin dhe Bunë në Dalmaci*", botuar në vitin 1688, mjaft e pasur me toponime e emërtime të sakta dhe të dhëna gjeografike, historike, etnografike, demografike për qytetet, krahinat, fshatrat e trojeve veriore shqiptare. Kjo hartë ka qenë burim i rëndësishëm për hartografët e mëvonshëm në paraqitjen e këtyre trojeve. Në hartat e shekullin XIX trojet shqiptare, si dhe në shekullin paraardhës, paraqiten më shumë si pjesë e Perandorisë Osmane, si ndarje administrativo-politike të kësaj Perandorie, në vilajete e sanxhakë, herë-herë të shoqëruara edhe me të dhëna statistikore për popullsinë e tyre. Vendbanimet në këto harta jepen me emërtimet e kohës. Shohin dritën e botimit edhe mjaft harta të tjera tematike, kryesisht etnografike, të cilat sjellin të dhëna statistikore për numrin e popullsisë, të shtëpive, të shkollave sipas kombësisë, besimit, përdorimit të gjuhës mbi bazën e sanxhakëve dhe të kazave. Mjafton të përmendim këtu hartën e Epirit të Enrico de Gubernatis, botuar sipas Legrand-it në vitin 1880. Siç pohon autori, për përpilimin e hartës ai është

intelektuale e hulumtuese të përdoruesve, lind nevoja e ripunimit dhe e katalogimit të automatizuar të koleksionit të hartave albanologjike, të integrimit të tij në katalogun elektronik. Këtë ripunim e bën të domosdoshëm edhe katalogimi shumë i vjetër dhe në kohë të ndryshme i këtij koleksioni. Skedat e katalogut tradicional janë tepër të vjetra dhe me mangësi e pasaktësi të shumta në përshkrimin bibliografik të fushave të caktuara. P. sh.: pjesa më e madhe e hartave është përshkruar me titull, kur ato kanë autorë (hartografin, gravuristin apo dizenjatorin). Ky katalogim, i cili tashmë ka filluar në bibliotekën tonë, do të çojë në:

- Përpunimin sipas standardeve bashkëkohore ndërkombëtare të përshkrimit të mate-rialeve bibliotekare në përgjithësi, dhe të atij hartografik në veçanti;
- Shmangien e pasaktësive në elementet bazë të përshkrimit bibliografik;
- Unifikimin e autorëve dhe të elementeve të tjerë të përshkrimit;
- Plotësimin e informacionit me ndihmën edhe të burimeve që ofron teknologjia e sotme, siç është Internet-i apo OPAC-u (Katalogu i shërbimit publik në rrjet) i bibliotekave të ndryshme të botës;
- Bashkimin e ekzemplarëve që kanë përshkrim të ndryshëm bibliografik;
- Kërkimin online të informacionit nga përdoruesi dhe rritjen e aksesit intelektual mbarëkombëtar e mbarëbotëror. Katalogu i hartave tashmë bëhet i aksesueshëm nga të gjithë, pavarësisht nga vendi dhe orari i bibliotekës. Informacioni del jashtë mureve të saj;
- Lehtësimin dhe përmirësimin e kërkimit në katalog (me autor, titull, klasifikim dhjetor e lëndor, emërtime gjeografike, shtëpi botuese etj.). Pra, përdoruesit mund të mbledhin informacion nga katalogë të ndryshëm tradicionalë tashmë nëpërmjët një katalogu të vetëm online;
- Kursimin e kohës së përdoruesit, e domosdoshme gjatë kërkimit nëpër skedarët tradicionalë;
- Lehtësimin e punës në hartimin e katalogëve dhe të bibliografive të mundshme për koleksionin e hartave;
- Mundësinë për krijimin e një katalogu të përbashkët të këtij koleksioni me Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës.

Për shkak të katalogimit shumë të vjetër të koleksionit të hartave, për një cilësi sa më të mirë dhe informacion sa më të saktë për përdoruesit, rikatalogimi i hartave albanologjike po kryhet *de visu*. Bibliografi merr në dorë çdo hartë dhe bën përshkrimin bibliografik të tij sipas standardeve të sotme. Deri tani janë kataloguar mbi 500 njësi, nga 1000 që mbart koleksioni i hartave. Gjatë përpunimit të hartave, veçanërisht atyre të shekujve XV-XVIII, tashmë në proces, ka pasur vështirësi të shumta si:

- Mungesa e autorëve, hartografë e gravuristë;
- Paraqitja e emrit të autorëve, nëse ka, në forma të ndryshme dhe me iniciale;
- Konfondimi i përpiluesit të hartës me gravuristin;
- Njësimi i botuesit me autorin;

mbështetur në rezultatet e studimeve dhe të udhëtimeve të tij në Shqipërinë e Jugut, përfshirë dhe Çamërinë. Harta, përveç pasqyrimit me saktësi të relievit të Shqipërisë Jugore, sjell të dhëna statistikore e demografike me interes për trevat e qytetet e paraqituara në të. Jepet numri i shtëpive të qyteteve e fshatrave, paraqiten zonat me popullsi shqipfolëse, greqishtfolëse dhe vllahishtfolëse etj. Hartat etnografike janë punuar më vonë edhe nga autorë shqiptarë, si: Nikolla Lako e Ahmet Gashi, të cilat, sipas mendimit të specialistëve, dallohen për vërtetësi në pasqyrimin e shtrirjes së shqiptarëve. Para dhe gjatë Luftës së Parë Botërore përpilohen një numër hartash topografike për krahina, fshatra e qytete të Shqipërisë dhe të Kosovës, ku kontribut kanë Instituti Gjeografik Ushtarak i Vjenës dhe ai i Firences. Në gjysmën e parë të shekullit XX dallohet në hartografimin me detaje dhe saktësi të territorit tonë gjeografi gjerman Louis Herbert, i cili në hartën gjeografike të Shqipërisë, botuar në vitin 1928 (rezultat i udhëtimeve të tij të shumta në vendin tonë), i paraqet lumenjtë në evolucionin e tyre historik, me shtretërit e vjetër dhe të rinj.

Pra, siç shihet, hartat janë dëshmi e historisë së ekzistencës së kombit tonë. Ato janë burim informacioni për fusha të ndryshme, që jo vetëm pasqyrojnë dukuritë gjeografike të kohës, na njohin me konturet e bregdetit dhe të brendësisë së vendit tonë, konstatojnë kufijtë e viseve tona në periudha të caktuara historike, por dhe kahjet e lëvizjes e të shpërndarjes së popullsisë, evoluimin kompleks të një krahine, qyteti a fshati etj. Në to secili prej nesh, posaçërisht studiuesit, do të gjejnë fushëveprim për hulumtimet e tyre, do të gjejnë të dhëna me interes albanologjik, njoftime për historinë, gjeopolitikën, kulturën, gjuhën e toponiminë e një krahine, fshati a qyteti, evoluimin e saj gjatë historisë, do të gjejnë të dhëna për florën dhe faunën, zhvillimin e bujqësisë e të komunikacionit. Hartat na mundësojnë të përcjellim me saktësinë më të madhe rritjen dhe rënien e qyteteve, madhësinë e pronave dhe të tokës së përbashkët.

Për nga informacioni që sjellin, veçanërisht hartat e vjetra, janë dokumente historike me vlerë për studiuesit e albanologjisë. Hartografia albanologjike ka qenë objekt sudimi më shumë i studiuesve të huaj (Franz Nopcsa, Roberto Almagia, Ermano Armao) dhe pak ose aspak është hulumtuar nga gjeografët, historianët, etnografët dhe gjuhëtarët shqiptarë. Ne bibliotekarëve e bibliografëve na bie barra ta bëjmë sa më prezent koleksionin e hartave të bibliotekës sonë, modest për nga numri, por i pasur dhe me interes për vlerat që mbart.

Përpunimi dhe trajtimi i hartave albanologjike

Koleksioni i hartave, veçanërisht ai i vjetër, është pjesë e trashëgimisë sonë kulturore e më gjerë. Si i tillë, ky koleksion duhet trajtuar e mirëmbajtur me kujdes. Në kushtet e sotme të një shoqërie të hapur, të informacionit të automatizuar e të digjituar, të rritjes së kërkesave

- Mungesa e vendit, e vitit dhe e shtëpisë botuese apo e shtypshkronjës;
- Gjuhët e ndryshme e të vjetra dhe përdorimi termave teknikë latinë në harta;
- Shkalla e zvogëlimit që përllogaritet me masa të ndryshme.

Me ndihmën e materialeve referative dhe të Internet-it, këto vështirësi i kemi kapërcyer tashmë dhe ndihemi më të sigurt e më të qartë në katalogimin e pjesës së mbetur.

Për t'u ardhur në ndihmë studiuesve të albanologjisë dhe bibliografëve në hartimin e katalogëve e bibliografive, vëmendje kemi treguar për zonën e shënimeve. Përveç shënimeve që kanë të bëjnë me elementë të veçantë të përshkrimit bibliografik, kujdes është bërë edhe për adnotimet mbi përmbajtjen e hartave, duke nxjerrë në pah çdo të dhënë të rëndësishme, që lidhet me shqiptarët dhe territorin e tyre. Në këtë pikë, kemi bërë kujdes në paraqitjen e brendësisë së Kosovës dhe të të dhënave që lidhen me vendbanimet dhe me popullsinë e këtij territori. Kemi vlerësuar në shënimet tona bibliografike edhe autografë dhuruesish apo personalitetesh të kulturës shqiptare, si: Mithat Frashëri etj., që kanë rëndësi për proveniencën e materialit bibliotekar dhe për historinë e zhvillimit të koleksioneve të Bibliotekës Kombëtare.

Çdo regjistrim në katalogun elektronik është pajisur me klasifikim dhjetor dhe me emërtime lëndore si një mundësi më tepër kërkimi në ndihmë të përdoruesit.

Me rikatalogimin e koleksionit albanologjik të hartave, informacioni për kategoritë e interesuara të përdoruesve do të jetë më i plotë dhe më i arrirë.

Mirëmbajtja dhe restaurimi i hartave

Ky koleksion i rrallë e me vlera i Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë, në shërbim të përdoruesve, posaçërisht të studiuesve të fushave të albanologjisë, duhet mirëmbajtur, trajtuar e restauruar, që të ketë jetëgjatësi e t'u vlejë edhe brezave të ardhshëm. Mirëmbajtja dhe restaurimi i dokumenteve bibliotekare është detyrë e përhershme e bibliotekave, veçanërisht e atyre kombëtare. Një libër, një hartë e restauruar sot, do të thotë një informacion më shumë nesër. Një bibliotekar i ndërgjegjshëm duhet dhe e ka detyrë të ndjekë gjendjen fizike të librit apo dokumentit bibliotekar, ashtu si nëna kujdeset për fëmijët e saj. Siç e kemi theksuar edhe më parë, në biblioteka të ndryshme të botës dokumentet e rralla dhe me vlerë janë të pajisura me kartela personale, përmes të cilave bibliotekarët evidentojnë dhe regjistrojnë elementë që kanë të bëjnë me qëndrueshmërinë, me lidhjen dhe me restaurimin e tyre. Kjo mënyrë të punuari e të vepruari parandalon dhe shmang degradimin e dokumenteve bibliotekare në përgjithësi e atyre të rralla në veçanti. Në bibliotekat tona ende nuk funksionon një paraktikë e tillë. Gjithçka i lihet spontanitetit. Trajtimi dhe restaurimi i dokumenteve hartografikë duhet të marrë përparësi dhe të bëhet i programuar. Janë vlera që sot e aq më pak nesër nuk kemi për t'i gjetur më.

Edhe përdoruesit e bibliotekave kanë

rolin e tyre në mirëmbajtjen e vlerave të rralla, sikurse janë edhe hartat me karakter albanologjik. Na takon ne, bibliotekarëve, t'i ndërgjegjësojmë dhe t'i edukojmë ata për vlerat që mbajnë në duar.

Në bibliotekën tonë hartat përgjithësisht janë në një kopje. Përdoruesit kanë të drejtën e tyre të informohen, dhe, nga ana tjetër, bibliotekat e kanë detyrë të informojnë dhe t'u shërbejnë përdoruesve. Por, duke u shërbyer përdoruesve kopjen e vetme në original, mundësia për dëmtim është e madhe. Ndaj, duhet të mendojnë për mënyrat e shërbimit të vlerave të rralla, për mundësinë e krijimit të kopjeve të tyre për përdorim. Një mënyrë është shërbimi për përdoruesit i ekzemplarit të riprodhuar me anë të mikrofilmimit apo të fotokopjimit, që është praktikuar edhe te ne. Kjo rrugë shmang degradimin dhe dëmtimin e ekzemplarëve në origjinal, por shërbimi mbetet i kufizuar, brenda mureve të bibliotekës. Teknologjia e sotme e informacionit na jep mundësi për krijimin e kopjeve për përdorim. Sot, në botë, ka marrë përparësi digjitimi i pasurive hartografike, duke vënë në shërbim të përdoruesve përmes Internt-it imazhet kompiuterike të hartave. Për këtë temë kemi folur dhe më parë, ndaj puna është që të fillojmë sa më parë digjitimin e hartave, të shpëtojmë kështu dëmtimin e mëtejshëm të tyre. Ky problem duhet bërë prezent, që nesër të mos gjendemi përpara fakteve të pariparueshme. Me pak shpenzime sot, ne duhet, e mundemi, t'i ruajmë këto pasuri, që nuk gjenden më. Digjitimin e hartave të koleksionit të Bibliotekës Kombëtare, e bën të domosdoshëm edhe gjendja jo e mirë fizike e tyre. Ka mjaft harta, përfshirë edhe botime të shekujve XVI-XVIII, të dëmtuara nga:

- Mënyra e keqvendosjes së tyre (e palosur), për shkak edhe të mungesës së hapësirave;
- Përdorimi i ekzemplarit në origjinal;
- Mungesa e kartelës, për të cilën folëm më lart, që do të mundësojë evidentimin e gjendjes fizike të hartave dhe marrjen e masave për ndalimin e dëmtimeve të mëtejshme;
- Mosfunksionimi sa duhet e si duhet i bashkërendimit të punës mdis sektorëve përkatës që merren me ruajtjen dhe restaurimin e këtyre vlerave;
- Mungesa e materialeve të domosdoshme për restaurimin e vlerave hartografike.

Të gjithë duhet të shqetësohemi e të punojmë fort për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e këtij koleksioni me vlera për kombin tonë. Eksperienca botërore dhe burimet njerëzore nuk mungojnë, por, duhen gjetur mjetet financiare që do të mundësojnë digjitimin e hartave dhe hedhjen e imazheve kompiuterike të tyre në Internet.

Bibliotekat Kombëtare – komunikimi albanologjik

Jehona SHALA
Biblioteka Kombëtare
dhe Universitare e Kosovës

Zhvillimi i kulturës sonë nacionale, edhe pse duke pasur për bazë një palcë të përbashkët etnike, si pasojë e rrethanave të ndryshme politike e ideologjike, ka përjetuar një dallueshmëri kulturore brenda llojit, që nuk është e njohur te popujt e tjerë.

Nëse vetë letërsia shqipe ka pasur një zhvillim atipik, në kuptimin e evolucionit të formave, zhanreve dhe temave, si dhe të formacioneve të mëdha stilistike, mund të themi se ka pasur një zhvillim atipik edhe sa i përket komunikimit të brendshëm të kësaj kulture. Kjo dukuri është e pranishme, sidomos pas ndarjes politike të shqiptarëve, ndarje e cila ndodhi pas Luftës së Dytë Botërore.

Shqipëria u mbyll, Kosova vazhdoi jetën e saj nën okupim. Produksioni letrar u nda dhe u krijua në dy qendra kulturore, në Tiranë dhe në Prishtinë. Duke marrë parasysh dhe respektuar një komunikim sporadik institucional, ndërmjet Prishtinës dhe Tiranës, prapë se prapë, mund të theksojmë se Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë dhe Biblioteka Kombëtare e Kosovës, për arsye të shtrëngesave politike nuk arritën të mbrojnë një komunikim të vazhdueshëm në shkëmbimin e literaturës albanologjike, literaturë, që u krijua në këto dy qendra të studimeve shqiptare.

Por me hapjen perëndimore të Shqipërisë, e në këtë rast edhe me Kosovën, si dhe me konsolidimin gradual të shtetësisë së Kosovës, mendojmë, se tashmë ekzistojnë kushtet normale për përmbushjen e zbrazëtive të mbetura të komunikimit kulturor ndërshqiptar-albanologjik.

Ky komunikim, tashmë, nuk ka nevojë të bëhet mbi baza vullnetare, të rastit apo edhe të qarqeve. Meqë

ekzistojnë dy Biblioteka Kombëtare, që e ruajnë të njëjtën kulturë, por që krijohet në dy shtete, roli i tyre në unifikimin sa më të madh të saj është tepër utilitar dhe substancial. Po themi utilitar dhe substancial duke pas parasysh vetëdijen se komunikimi i plotë i dijes albanologjike në krejt hapësirën shqiptare, qoftë në Kosovë, qoftë në Shqipëri, do të eliminonte shumë paragjykime, të cilat mund të ekzistojnë edhe në kohë moderne, në rastet kur nuk ekziston komunikimi institucional.

Kështu që, duke e ditur se komunikimi i librave të albanologjisë me lexuesin shqiptar bëhet kryesisht me anë të shkëmbimeve parciale dhe të blerjeve të herëpashershme të tyre, veprime këto që nuk mund ta krijojnë tërësinë e fondit të shkruar në fushë të albanologjisë, fond i cili do të ishte në dispozicion të lexuesit shqiptar, mendojmë se lidhur me këtë fenomen nevojitet *ndërhyrja* institucionale shtetërore, pra e bibliotekave tona.

Fjalën *ndërhyrje* nuk duhet ta marrim në kuptimin pezhorativ, por kjo duhet të shihet si nevojë e një kujdesi të shtuar, që bibliotekat tona, tashmë me mundësitë e avancuara teknike dhe teknologjike, të pasurojnë fondet e tyre me tërë korpusin e veprave në fushë të albanologjisë, që janë krijuar dhe krijohen në Tiranë dhe Prishtinë.

Kjo do të akomodonte shkëlqyeshëm lexuesin shqiptar, për të mos bredhur nga Tirana në Prishtinë dhe anasjelltas për të gjetur një libër, që në një moment të caktuar mund të konsiderohet si i rrallë, me pak ekzemplarë, i botuar në ndonjë ndërmjetëz ose edhe "i harruar" etj. Kjo kërkesë bazohet në faktin se libri që vjen nga Tirana është blerje, e cila i nënshtrohet një seleksionimi arbitrar të kufizuar edhe nga buxhetet vjetore, si dhe nga shije të ndryshme, të cilat mund të mos përfshijnë natyra të ndryshme lexuesish. E njëjta ndodh edhe me librin që vjen nga Prishtina në Tiranë. Libri i Prishtinës edhe kur mbërrin në Tiranë, në rast të dhuratave me motivime të caktuara, nuk e kapërcen një ekzemplar të vetëm, që, si i tillë, me sistemin e bibliotekave mund t'i nënshtrohet statusit të librit të mbrojtur.

Pikëpyetja jonë në këtë rast është: si mund të zhvillohet komunikim modern i dijeve albanologjike ndërmjet dy qendrave kulturore shqiptare, Tiranës dhe Prishtinës, kur libri i kësaj natyre "qarkullon" vetëm si dhuratë, shkëmbim ose blerje e bazuar në shijet e rastit? Një ekzemplar, qoftë i shkëmbyer, qoftë i dhuruar, mund të ketë vlerën e evidencimit dhe të ruajtjes së trashëgimisë, por, kurrsesi fuqinë që e kërkon komunikimi normal i lexuesit me librin. Prandaj, propozojmë që, për hir të lexuesit shqiptar, dy institucionet tona të krijojnë mekanizma institucionalë të formave më adekuate, që të bëhet një "bashkim" i fondit kulturor albanologjik në të dyja qendrat. Kjo do të mund të realizohej me kërkesën për rritjen e numrit të ekzemplarit të detyruar, ku, ta zëmë, pesë ekzemplarë mbesin për bibliotekën amë, ndërsa pesë ose eventualisht tre të tjerë shkojnë te biblioteka homologe.

Kjo ndërmarrje do të ishte në interes të të gjithëve: lexuesve, botuesve, autorëve, studiuesve, studentëve etj. Kjo mundësi do të krijonte lehtësi për faktin se librat që janë me interes për ta, lexuesit do

t'i gjejnë në bibliotekën kombëtare në kryeqytetin e tyre; botuesve do t'ua mundësonte qarkullimin e tyre përtej kufijve fizikë të vendeve, me ç'rast edhe komunikim më të gjerë; autorëve do t'u mundësonte njohje me të madhe me lexuesin e mundshëm; studiuesve dhe studentëve do t'u krijonte komoditet në plotësimin e kërkesave të tyre për njohje dhe hapje me të gjerë ndaj dijeve albanologjike të cilësdo fushë qofshin ato.

Për realizimin e kësaj nisme, në planin teknik, do të nevojitej krijimi i dy departamenteve profesionale brenda dy bibliotekave, të cilat do të kishin për detyrë koordinimin e plotë me të gjithë botuesit e vendeve përkatëse për realizimin e këtij projekti të komunikimit të mirëfilltë në fushë të albanologjisë.

Efekti i këtij unifikimi do ta justifikonte dhe motivonte më fuqishëm cilësimin Bibliotekë Kombëtare, si për atë të Tiranës, ashtu edhe për atë të Prishtinës. Sepse kjo do ta fuqizonte bindjen tonë historike se jemi një kulturë e pandarë, e cila bazën me të fuqishme e ka në librat e albanologjisë, të vjetër e të rinj, të cilët ne duhet t'i bëjmë të komunikueshëm për lexuesin shqiptar, pavarësisht se në cilën nga këto dy qendra të kulturës ndodhet.

Karakteri albanologjik i funksioneve të Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë

Farfuri XHAJA
Biblioteka e Universitetit Amerikan, Tiranë

Regjistrimet e dokumentuara shkencore, edukative dhe krijuese pasqyrojnë trashëgiminë kulturore të kombit

Brezi i sotëm ka detyrën e shenjtë të sigurojë dhe ruajë këto regjistrime; publiku ka të drejtë t'i përdorë në shërbim të zhvillimit të edukimit, zhvillimit kulturor, veprimtarisë ekonomike dhe çlodhjes. Janë të shumta materialet e UNESCO-s dhe të IFLA-s, që përcaktojë detyrat dhe funksionet e bibliotekës kombëtare dhe pozicionin e saj në sistemin bibliotekar kombëtar, si institucion i rëndësishëm kombëtar, shprehje e identitetit kombëtar dhe depozituese e trashëgimisë kombëtare. Ajo ka përgjegjësi të veçanta brenda kuadrit të sistemit kombëtar bibliotekar dhe të informacionit. Të gjithë elementët e këtij përcaktimi bartin vlera kombëtare dhe, po t'i referohemi bibliotekës tonë kombëtare, përbëjnë vlera albanologjike. Kontributi i Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë (BKSh) në fushën e albanologjisë vërehet në objektivat dhe funksionet e saj.

Disa nga objektivat e Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë janë:

a) Të mundësojë përdorimin e koleksioneve kombëtare të burimeve bibliotekare nga brezat e sotëm dhe të ardhshëm;

b) Të sigurojë qasje kombëtare në burimet bibliotekare, që gjenden brenda dhe jashtë vendit;

c) Të luajë rolin e lidershipit në çështjet bibliotekare.

Funksionet e Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë lidhen me:

1) *Trashëgiminë,* që do të thotë:

- Pasurim të plotë me materialet e botuara në vend dhe ato që kanë lidhje me vendin dhe gjuhën tonë;
- Ruajtje e këtyre materialeve;
- Regjistrim bibliografik gjithpërfshirës korrent e retrospektiv;
- Akces në materialet e trashëgimisë kulturore me shërbim direkt të materialeve origjinale, kopje ose të

digjituara dhe të transmetueshme elektronikisht;

- Shërbime informuese e referuese, si edhe udhëzime për koleksionet e trashëgimisë;

- Promovim i këtyre koleksioneve me ekspozita, konferenca, botime etj., veprimtari ku ka përvojë dhe rezultate shumë të mira.

2) Infrastrukturën ose ndërtimin e kapaciteteve kombëtare për shërbime bibliotekare dhe të informacionit

- Kujdeset për ruajtjen në shkallë kombëtare të trashëgimisë duke planifikuar dhe koordinuar veprimtarinë restauruese;

- Në rolin e Agjencisë Bibliografike Kombëtare përgatit regjistrimet bibliografike, i shkëmben ato (përmes website-it dhe pjesëmarrjes në Bibliotekën Europiane) dhe nxit zbatimin e standardeve. Në kuadrin e rolit të Agjencisë Kombëtare Bibliografike ka edhe detyrën e koordinimit të veprimtarisë bibliografike në vend;

- Siguron përdorimin e koleksioneve duke praktikuar huazimin kombëtar dhe ndërkombëtar;

- Kryen shërbime kombëtare informuese dhe referuese për burimet e vendit. Kjo është një çështje që kërkon krijimin e rrjetit bibliotekar kombëtar dhe të katalogut unik;

- Ka rolin e lidershipit profesional e teknologjik (me ekspertë që marrin pjesë në forume kombëtare dhe ndërkombëtare);

- Kryen shërbime konsultimi për bibliotekat e tjera. Organizon formim dhe trajnim profesional (kurse, seminare etj.);

- Kryen kërkime me vlerë kombëtare për sistemin bibliotekar në vend.

3) *Bashkëpunimin ndërkombëtar*

- Veprimtaria botuese kombëtare dhe regjistrimi bibliografik i produktit të saj përbëjnë bazën e kontributit në kontrollin bibliografik universal dhe të disponueshmërisë universale të botimeve;

- BKSh është qendra kombëtare për promovimin e standardeve ndërkombëtare.

Këto janë disa nga funksionet e Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë, që vënë në dukje karakterin albanologjik të saj.

Por, në ç'masë realizohen këto funksione? Si vlerësohen arritjet e një biblioteke kombëtare?

Matja e treguesve të rezultateve është faktor me rëndësi për projektimin e zhvillimeve të ardhshme. Standardi Ndërkombëtar ISO 11620 (International Standards for Library performance indicators), - standard për treguesit e bibliotekave, - përcakton treguesit për matjen e arritjeve të bibliotekave dhe

synon përfshirje të të gjitha llojeve të bibliotekave. Ky standard është i mirënjohur nga komuniteti ynë bibliotekar; është analizuar në seminare trajnuese me punonjës të bibliotekave të rrjetit kombëtar për t'u vënë në zbatim dhe për të unifikuar treguesit në të gjithë sistemin bibliotekar të vendit. Po t'u referohemi detyrave dhe funksioneve që karakterizojnë bibliotekat kombëtare, IFLA dhe Konferenca Europiane e Bibliotekave Kombëtare venë në dukje se treguesit e arritjeve të përcaktuar në standardin ISO 11620 nuk mbulojnë tërësisht veprimtarinë e bibliotekave kombëtare, ndaj ato mundësuan zgjerimin e këtij standardi me tregues të tjerë të posaçëm për të pasqyruar detyrat kryesore të këtyre bibliotekave. Bibliotekat kombëtare janë unike në çdo vend; ndaj dhe të dhënat e tyre nuk janë të krahasueshme me bibliotekat e tjera të vendit. Projekti i ri i ISO 11620 synon të përshtasë treguesit e arritjeve me funksionet dhe objektivat e bibliotekave kombëtare dhe të shtojë tregues të posaçëm për detyrat e veçanta të tyre. Drafti përqendrohet në kombinimin e të dhënave, që tregojnë më shumë cilësi se sa sasi. Megjithatë, janë disa statistika, si p.sh. shifrat për vizitorë (në vend ose në website), për pasurimin e koleksioneve, zërat bibliografikë, huazimet, veprimtaritë dhe ndjekja e tyre, që shihen si sasi.

Krahas treguesve ekzistues, disa nga treguesit, që shtohen për bibliotekat kombëtare, të grupuara sipas tematikës, janë:

1) Për koleksionin kombëtar

- Përqindja e botimeve kombëtare, të siguruara nga biblioteka kombëtare, për të parë se në ç'masë biblioteka mbulon krijimtarinë kombëtare të shkruar në formë tradicionale dhe elektronike. Kjo mund të bazohet vetëm në botimet komerciale ose mund të përfshihen dhe ato jokomerciale, por duke u dhënë të veçanta. Realizimi i këtij treguesi kërkon përpjekje për gjetjen e informacionit për botimet, pasi dihet që informacioni nga zyra e ISBN-së dhe përmes katalogëve të botuesve nuk është i plotë;

- Përqindja e titujve të kërkuar për të parë se në çfarë shkalle janë siguruar nga biblioteka titujt e kërkuar nga përdoruesit. Është fjala për tituj që për shkak të vendit të botimit, gjuhës dhe vlerës kombëtare duhet të bëjnë pjesë në koleksionin e bibliotekës kombëtare;

- Përqindja e titujve unikë në koleksionin kombëtar për të evidentuar se në ç'nivel biblioteka kombëtare mbulon atë pjesë të prodhimtarisë së kulturës kombëtare, që nuk gjendet në bibliotekat e tjera.

Realizimi i këtij treguesi kërkon shkëmbim informacioni me bibliotekat e tjera të vendit, por që do të realizohej me krijimin e katalogëve elektronikë të këtyre bibliotekave dhe më tej të katalogut unik kombëtar. Kjo është një çështje që kërkon bashkëpunim serioz nga të dy palët.

2) Koleksioni i botimeve të huaja

- Përqindja e shpenzimeve për pasurimin me literaturën e huaj për të vlerësuar angazhimin e bibliotekës kombëtare në detyrën e mirëmbajtjes dhe zgjerimit të një koleksioni universal.

Standardi sugjeron se koleksioni

i literaturës së huaj mund të jetë i kufizuar në subjekte të caktuara, p.sh. në shkencat humanitare. Është fjala për botime të huaja të çdo formati rreth vendit dhe kombit shqiptar. Orientimet e IFLA/UNESCO-s nuk përjashtojnë dhe burimet e huaja të informacionit me karakter të përgjithshëm, me argumentin se i shërbejnë përdoruesit si dritare për të parë botën

3) Akcesi i koleksioneve: katalogimi

- Regjistrimt e reja në bibliografinë kombëtare duke iu referuar botimeve të dy viteve të fundit, për të vlerësuar shpejtësinë në pasurim dhe katalogim;

- Përqindja e materialeve të rralla të kataloguara, të pasqyruara në katalogun elektronik në web, për të parë nëse katalogu i botimeve të rralla është i akcesueshëm dhe veçanërisht përmes web-it.

Sipas standardit, këtu përfshihen doréshkrimet, inkunabulat dhe materiale të tjera të rralla të shekujve XVI-XX. Treguesi përmban numrin e materialeve të rralla, numrin e atyre të kataloguara, numrin e njësive të pasqyruara në katalogët në web. Ky tregues pasqyron angazhimin e bibliotekës kombëtare në bërjen e koleksionit të akcesueshëm përmes bibliografive dhe katalogëve në web.

4) Shpejtësia dhe saktësia e akcesit në koleksione

- Krahas kohës mesatare të përpunimit të materialeve, për të parë efektivitetin e procedurave të përpunimit në raport me shpejtësinë, ku llogaritet koha nga momenti i hyrjes në bibliotekë deri në vënien në shërbim të përdoruesve, evidentohet koha mesatare e gjetjes së dokumenteve në fonde të mbyllura që nga momenti i paraqitjes së kërkesës deri në marrjen nga përdoruesi, për të vlerësuar efektivitetin e sistemit të kërkimit dhe gjetjes. Siç dihet bibliotekat kombëtare praktikojnë fonde të mbyllura.

5) Përdorimi i koleksioneve

- Përveç treguesve të huazimit mbahen të dhëna edhe për përdorimin e bazave të të dhënave për të parë sesa të përshtatshme janë ato për përdoruesit. Treguesi përmban frekuentimin fizik dhe atë virtual.

6) Digjitimi

- Përqindja e titujve të digjituar në vit ndaj numrit të titujve të koleksionit, për të parë se në ç'masë biblioteka plotëson detyrën e saj për vënien në dispozicion të publikut edhe në distancë trashëgiminë kulturore të shkruar;
- Lidhur me digjitimin evidentohet dhe numri i shkarkimeve të përmbajtjes së çdo dokumenti të digjituar nga biblioteka për të parë nëse janë digjituar ato materiale që janë më të kërkuara nga përdoruesit.

Këta tregues vlerësojnë përpjekjet e bibliotekës për t'u dhënë mundësi përdoruesve të akcesojnë koleksionet në distancë.

7) Ruajtja e koleksioneve

- Këtu evidentohet përqindja e njësive

që janë trajtuar për ruajtje ndaj njësive të koleksionit në tërësi. Treguesi detajohet sipas metodës së përdorur: mikrofilmim, digjitim, deacidim, metoda tradicionale të ruajtjes;
- Gjithashtu dhe përqindja e koleksionit që gjendet në kushte mjedisi të përshtatshme, si rezultat i monitorimit të temperaturës dhe lagështisë për lloje të ndryshme të materialeve bibliotekare.

Këta tregues vlerësojnë përpjekjet e bibliotekave kombëtare për ruajtjen e koleksioneve, përfshirë dhe ato elektronike.

8) Bashkëpunimi ndërkombëtar

- Përqindja e punonjësve të angazhuar në detyra dhe projekte ndërkombëtare për të vlerësuar angazhimin ndërkombëtar të bibliotekës. Këta janë disa nga treguesit e vlerësimit të veprimtarisë së bibliotekave kombëtare, krahas treguesve të tjerë tradicionalë. Një pjesë e tyre kanë hyrë në listën e treguesve, që mbahen rregullisht nga BKSh-ja, ndërsa disa të tjerë ende nuk janë përfshirë në praktikën e punës së bibliotekës tonë.

Paraqitja ime ishte një përpjekje për të cilësuar vetëm disa elementë të raportit të bibliotekonomisë me albanologjinë, por, nuk ka dyshim se tërë veprimtaria e Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë është kontribut në ruajtjen dhe përdorimin e trashëgimisë kombëtare, dhe, për pasojë, në nxitjen e studimeve albanologjike. Ndoshta vlen të përkrahet përvoja e disa bibliotekave kombëtare botërore, të cilat kanë caktuar një ditë të vitit si "Dita e trashëgimisë e bibliotekës kombëtare", ditë, në të cilën promovojnë vlera të trashëgimisë kombëtare, që ato disponojnë.

Zhvillimi i koleksioneve albanologjike në mjedisin digjital

Etleva DOMI
Biblioteka Kombëtare
e Shqipërisë

Përpara se të nis kumtimin tim sot, do të doja t'ju bëja me dije, që jam përpjekur të jap një paraqitje jo vetëm teknike, por, mbështetur edhe në eksperiencën time disavjeçare, si specialiste e zhvillimit të koleksioneve albanologjike, të sjell një panoramë si të risive, ashtu edhe të problemeve, me të cilat ndeshemi në mjedisin digjital që na rrethon sot.

Zhvillimi i koleksioneve dhe Interneti

Revolucioni kompiuterik, - pjesë e pandashme e bibliotekave në epokën digjitale, - shtrirja e Internetit, - këtij rrjeti kompiuterik gjigand, - në mbarë botën, nuk ka se si të mos të ndjehet edhe në të dy institucionet tona, tradicionalisht të njohura si "fole" konservatore të kujtesës dhe trashëgimisë, dhe tanimë si qendra "fleksibël" informacioni. Shtrirja e Internetit, zhvillimi marramendës i teknologjive të informacionit, në mënyrë të natyrshme na udhëheq drejt një kuptimi të ri të rolit të bibliotekave në shoqërinë moderne. Dhe në këto kushte, bibliotekarët, si pjesëtarë në lëvizjen drejt një infrastukture të informacionit digjital, duhet të kujtojnë Michael Gorman-in, i cili në ditët tona ka riformuar 5 ligjet e bibliotekonomisë të Ranganatan-it, të formuluara në vitin 1932.

Sipas atij formulimi bibliotekat:

1) I shërbejnë njerëzimit;
2) Respektojnë të gjitha format që mundësojnë komunikimin e dijes;
3) Përdorin teknologjitë në mënyrë inteligjente për të shtuar shërbimet;

4) Ruajnë qasjen e lirë në dije;
5) Respektojnë të shkuarën dhe krijojnë të ardhmen.

Në mjedisin digjital situata na paraqitet disi e ndërlikuar. Nga njëra anë Interneti lejon mundësira të pafundme qasjeje në burime të ndryshme informacioni me ose pa pagesë nga ana tjetër, bibliotekat, si institucione sociale, duhet ta garantojnë këtë qasje në mënyrë të barabartë për të gjithë, duke marrë në konsideratë edhe kërkesat e përdoruesve. Por kjo kërkon një filozofi të re për zhvillimin e koleksioneve bibliotekare. Në të tilla rrethana, specialistët e zhvillimit të koleksioneve, përfshirë edhe ato albanologjike, me zgjerimin e rrjetit botëror të komunikimit, World Wide Web-it, që prej zanafillës së tij në vitin 1993, duhet të gjykojnë dhe vlerësojnë me mendjekthjethtësi.

Në mjedisin digjital koncepti i "Zhvillimit të koleksioneve albanologjike" ka ndryshuar dhe ndofta ne duhet të mendojmë për një përkufizim të tij, i cili do të duhet të përfshijë: hartimin e politikave për të udhëhequr seleksionimin; zevendësimin e materialeve të dëmtuara ose të humbura; plotësimin e koleksioneve, që për arsye të ndryshme - politike, ideologjike, fetare, ekonomike etj. - mungojnë ose/nuk janë të plota në fondet tona; spastrimin e materialeve të panevojshme për t'u klasifikuar si të tilla; si dhe planifikimin e koleksioneve të reja qofshin këto materiale të shtypura apo grafike, dëgjimore-pamore apo burime elektronike etj.

Për një zhvillim të koleksioneve tanimë krejt ndryshe

Kur epoka e informacionit elektronik filloi të ketë impakte në bibliotekat shqiptare në mesin e viteve '90, bibliotekarët ishin pa shumë eksperiencë dhe për ta ishte vërtet sfidë për të vendosur nëse investimi në teknologjinë e re do të kishte siguri. Tani, koha vërtetoi që nuk bëhet fjalë për dilema të tilla. Ka kohë që po bien këmbanat për kalimin nga filozofia e mbledhjes në atë të qasjes në burime, si dhe e rikonceptimit të politikave të zhvillimit të koleksioneve bibliotekare, pasi edhe ndryshimi më radikal, nuk lidhet me teknologjitë, por me politikat, të cilat mbështeten në dy koncepte: "Ilojet e informacionit", ku përfshihet si formati i shtypur edhe ai elektronik" dhe "shkalla e qasjes", që i referohet suportit teknologjik për të mundësuar qasjen elektronike.

Teknologjia elektronike dhe *zhvillimi i koleksioneve* janë dy probleme të mprehta me të cilat po ndeshen sot si bibliotekat, ashtu edhe shkenca e informacionit. Ndërkohë kur "botimet elektronike" luajnë rol të veçantë për zhvillimin e koleksioneve, të cilat përkufizohen si "ndërtesa të vendosjes sistematike të burimeve të informacionit, ku bibliotekat mundësojnë qasjen", duhet të kujtojmë që me të vërtetë parimet tradionale të "zhvillimit të koleksioneve", të zbatuara në epokën e shtypshkrimeve, nuk kanë ndryshuar në mënyrë radikale, por me zhvillimin e teknologjive të reja,

një fushë të caktuar interesi, siç është ajo e albanologjisë, është lehtësuar si nga komunikimi nëpërmjet *postës elektronike,* ashtu edhe nga përfshirja në listservers, të mundësuara po nga Interneti. Mjeti më i vlefshëm informues dhe/ose rekomandues është padyshim gjetja dhe *regjistrimi në një listserver,* që lidhet me interesin e ngushtë.

Çfarë i ofron sot Interneti një specialisti të zhvillimit të koleksioneve albanologjike?

Site të botuesve, ku krahas katalogut të botimeve të tyre, jepet edhe një paraqitje e shkurtër. Numri i tyre po rritet nga dita në ditë.

Editoritë digjitale, ku botuesi vë në dispozicion veprën apo organe të ndryshme të shtypit periodik vetëm në variantin elektronik dhe propozon forma të abonimit në katalogun digjital.

Librin virtual, i cili, gjatë lundrimit në rrjet në sajë të programeve të leximit pa pagesë, arkivohet lehtësisht për përdorim.

Një numër jo të vogël librarish virtuale, si : Amazon, Blackwell etj., që ofrojnë një mori titujsh dhe elementë të ndryshëm kërkimi për përdoruesit, si p.sh.: kërkim me autor, titull, fjalë kyçe, subjekt, ISBN etj. Gjithçka lëviz me një kartë apo mesazh elektronik. Avantazhi më i madh është që tregu elektronik na informon menjëherë për çdo lloj materiali nëse është i disponueshëm apo jo (në qarkullim për blerje). Çdo bibliotekë mund të kërkojë e porositë libra mbështetur në kriteret e pasurimit të fondeve apo interesat e lexuesve. Në atë raste kur libri është i disponueshëm, sigurohen kopje të tij.

Shfrytëzimin e katalogëve nëlinjë/ online të bibliotekave. Me anë të Internetit mund të konsultohet edhe katalogu nëlinjë/online i të gjithë bibliotekave, që e posedojnë atë, çka ndihmon për të zgjedhur librat. Ky realitet, tashmë i përhapur, i mundëson kërkuesit të konsultojë katalogun e bibliotekave të ndryshme.

Abonimin në katalogun digjital (nëlinjë/online.) Nëpërmjet Internetit ekziston mundësia që botuesi të vëërë në dispozicion veprën apo organe të ndryshme të shtypit periodik dhe të propozojë forma *abonimi në katalogun digjital.* Vitet e fundit shumica e revistave dhe gazetave të shtypura shqiptare dhe të huaja kanë faqet e tyre në Internet.

Qasjen në web-site të pafundme informacioni, baza bibliografike të dhënash duke filluar nga OCLC-ja e deri te portale bashkëkore si EUROPEANA, si burime informuese për botime albanologjike, që u mungojnë koleksioneve tona.

Website periodiku. Vitet e fundit shumica e revistave shkencore gjenden edhe në Internet. Duhet bërë kujdes që të shmangen abonimet apo blerjet e titujve që gjenden online/në rrjet pa pagesë.

si metodat e vendimmarrjes, ashtu edhe kriteret e seleksionimit, duhet të përditësohen duke bërë kujdesin e përfshirjes edhe të formave të reja të botimeve.

Influenca e burimeve të Internetit në zhvillimin e koleksioneve albanologjike duhet parë në dy aspekte: *së pari,* zhvillimi i burimeve dhe/ose koleksioneve nëpërmjet qasjes së kërkimit në tekst të plotë apo baza të dhënash bibliografike, libra elektronikë, periodikë etj; *së dyti,* përdorimi i burimeve të Internetit në procesin e seleksionimit, verifikimit të të dhënave bibliografike.

Burimet e Internetit si pjesë integrale e koleksioneve bibliotekare

Ne sot jemi dëshmitarë të ndryshimeve dinamike si në strukturë, ashtu edhe në përmbajtje të burimeve të Internetit. Përballë komercializmit, që imponohet gjithnjë e më shumë, ne po ndeshemi me sfidën e vendosjes së një ekuilibri, balancimi të caktuar ndaj burimeve që ofron Interneti. Jemi edhe përpara dilemës: si duhet ta zgjidhim problemin e raportit ndërmes materialeve tradicionale, atyre elektronike (CD/ROM apo DVD) dhe burimeve të Internetit në zhvillimin e koleksioneve albanologjike.

Duhet bërë kujdes që në oqeanin elektronik të seleksionojmë burimet më cilësore, që mundësisht që të jenë të qasshme në linjë/online, pasi kjo mundëson shfrytëzimin nga një numër i madh përdoruesish brenda apo jashtë mureve të bibliotekës, e cila tanimë duhet të njihet si një qendër informacioni bashkëkohore albanologjike, ku krahas burimeve tradicionale, si: skedarë manualë apo elektronikë, katalogë apo bibliografi, skedarë apo objekte të digjituar, duhet të ofrojë edhe burime elektronike, ndonëse pjesa më e mirë e tyre nuk mundësohen falas, çfarë do të kërkonte një planifikim të menduar mirë edhe për abonime të botimeve periodike në formë eletronike.

Përdorimi i Internetit në teknologjinë e zhvillimit të koleksioneve

Dihet tanimë që Interneti ka ndryshuar krejt tregun tradicional të librit dhe marketingun e tij. Interneti është instrumenti më i fuqishëm që unë përdor në pasurimin e koleksioneve albano-logjike. Interneti ofron shërbim të shpejtë e të saktë, jo vetëm për lexuesin, por edhe për vetë bibliotekat. Mjaft veprime, si: kërkimi online i katalogëve të bibliotekave, botuesve apo librarive tanimë kryhen nëpërmjet Internetit. Detyrat tradicionale, kur shfrytëzonim materiale të shtypura si, katalogët: *Books in print, Livres disponibles etj.,* bibliografitë kombëtare, verifikonim të dhënat bibliografike apo mezi prisnim të shfletonim rubrikën e recensioneve në revista apo gazeta, në ndonjë rast pse jo edhe aparatet shkencore të artikujve, me ndihmën e Internetit janë bërë mënyra të zakonshme të punës sonë të përditshme. Edhe këshillimet me kolegë të institucioneve të tjera apo qendrave albanologjike për botime të

mjaftueshme dhe praktikat "tradicionale" nuk janë dhe aq bashkëkohore. Dhe kjo është një tjetër sfidë.

Pra, ka ardhur koha që specialistët duhet të mendojnë edhe për materiale elektronike në bibliotekat e tyre. Problemi, me të cilin përballemi sot, është se për çfarë materialesh digjitale albanologjike kemi nevojë ne, sot, në bibliotekat tona, dhe aspak ai i skeptikëve që predikojnë boom-in e librit elektronik dhe zhdukjen e librit të shtypur për 10 vjet. Historia ka treguar që ashtu si televizioni që kurrë nuk mundi të zëvendësojë radion apo aeroplanët trenat, as botimet elektronike nuk do të mund të zëvendësojnë krejt ato të shtypurat. Prandaj, në hartimin e politikave të pasurimit duhet kihet të kohet parasysh që ka ardhur koha që duhen riparë politikat e zhvillimit të koleksioneve dhe specialistët duhet të mendojnë e gjykojnë për:

§ *Risitë e botimeve albanologjike elektronike kundrejt atyre të shtypshkruara;*
§ *Përcaktimin e një fondi të veçantë në buxhet për të mundësuar sigurimin edhe të objekteve të reja të digjituara apo të lindura si të tilla;*
§ *Modalitetet e qasjes në to duke patur parasysh edhe problemin e të drejtës së autorit.*

Përdoruesi kërkon politika të reja për zhvillimin e koleksioneve

Politikat e zhvillimit të koleksioneve vijimisht rishikohen, përshtaten, simbas ndryshimeve që imponon koha. Në një mjedis digjital, kërkesat e përdoruesve ndryshojnë nga ato të së kaluarës. Megjithatë, është e paevitueshme që zhvillimi i koleksioneve dhe udhëzuesit e ndryshëm profesionalë, që mund të përpilohen në shërbim të tij, të mos marrin në konsiderate risitë botuese, kërkesat e përdoruesve, ndryshimet dhe zhvillimet sociale dhe ekonomike. Nënvizoj që "Botimi elektronik ka implikim të thellë në zhvillimin e koleksioneve, që është përkufizuar si "ndërtesë sistematike dhe ndërkombëtare e seteve të burimeve të informacionit", që bibliotekat i bëjnë të qasshme. Parimet bazë të zhvillimit të koleksioneve - të zhvilluara në botën e botimeve të shtypshkruara - nuk është se kanë ndërruar krejt me implementimin e teknologjive të reja të botimit për çfarë i përket vendimmarrjes në përzgjedhje. Impakti i burimeve elektronike në zhvillimin e koleksioneve është i prekshëm.

Në katalogun elektronik të BKSh-së numërohen 209 materiale audiovizuale. Statistikat e viteve të fundit dëshmojnë që hyrjet datojnë prej vitit 2007 dhe dallojmë dy kategori: 1) botime të mirëfillta elektronike, siguruar kryesisht nga dhuratat (116) dhe 2) libra të shoqëruara edhe me CD (32), të mundësura nga detyrim ligjor i dorëzimit të ekzemplarit të detyruar nga botuesit, por jo të karakterit albanologjik. Ndonëse të pakta në numër, vitet e fundit, materialet elektronike albanologjike renditen krahas atyre tradicionale në koleksionet tona.

Ishte një kohë kur përzgjedhjen për pasurimin e koleksioneve e mbështesnim

Bibliotekat digjitale, të cilat janë burime për hyrje në informacion, ku informimi kryhet me një të klikuar të mouse-it.

Bibliografitë kombëtare në linjë/ online. Avantazhi i tyre është që ato listojnë gjithçka që është botuar në vendet e tyre, botimet i kanë të renditura dhe të mirëorganizuara; përshkrimi bibliografik mbështetet në standarde; ndihmojnë në verifikimin e informacionit bibliografik; ofrojnë indekse të llojeve të ndryshme etj.

Burimet elektronike. Sfidat e integrimit të burimeve elektronike dhe teknologjive të reja në procesin e zhvillimit të koleksioneve janë të shumta. Përtej procesit të seleksionimit në vetvete, ka edhe probleme, jo të pakta, lidhur me menaxhimin e buxhetit, politikave, personelit dhe teknologjisë. Këtu do të ndalem pak më shumë.

Natyrshëm lind pyetja: Po bibliotekat shqiptare a i shfrytëzojnë këto risi?

Them se po. Por, mos harrojmë që jo të gjitha bibliotekat shqiptare, të cilat kanë në fondet e tyre koleksione albanologjike, e shfrytëzojnë këtë lehtësi të ofruar në mjedisin digjital që na rrethon. Specialistët hasin si vështirësi teknike, ashtu edhe financiare në përdorimin e burimeve të Internetit për të mundësuar pasurimin e koleksioneve albanologjike. Rendisim disa prej tyre: infrastrukturë e pazhvilluar, mungesë pajisjesh, pamundësi për të paguar shpenzimet e Internetit, lidhje në rrjet etj. Por, edhe në këto kushte, një specialist i kujdesshëm dhe i aftësuar në informacion duhet të kujdeset për të mundësuar edhe informacionin e CD-ve apo DVD-ve.

Sfidat

Me "agimin" e epokës digjitale, problemi më i madh për zhvillimin e koleksioneve albanologjike është sfida me të cilën po përballemi në botën elektronike, ku çdo gjë duket që po shkon drejt digjitales. Kërkesa për revista apo baza të dhënash nëlinjë është në rritje. Bibliotekat tradionale po kthehen në biblioteka digjitale hibride. Vështirë që të mund të gjendet sot bibliotekë që në fondet e saj të ketë vetëm koleksione të shtypshkruara. Kur u ndesha rastësisht me një pedagog universiteti, të cilin kisha kohë pa e parë që të frekuentonte bibliotekën, u shokova kur dëgjova prej tij, që gjithçka që i nevojitej e gjente në Internet dhe në "Google". Menjëherë, si specialiste e pasurimit, pyeta veten time: "A i ka biblioteka vërtet koleksionet albanologjike që kërkojnë përdoruesit?" apo "Përdoruesit kanë nevojë më shumë për informacion nga bibliotekarët?" në një kohë kur po rritet një "gjeneratë elektronike", e cila kërkon një informacion të shpejtë, të lehtë për t'u qasur në çdo kohë e nga kudo. Kur industria botuese, për ditë e më shumë, po përpiqet që t'u përgjigjet këtyre kërkesave, edhe bibliotekarët duhet të ndërgjegjësohen që njohuritë bazë, marrë në shkollë për zhvillimin e koleksioneve në epokën e kibernetikës nuk janë të

në radhë të parë për libra e periodikë, duke u mbështetur në materiale standarde referuese (katalogë të botuesve, bibliografi, rubrika promovuese në revista a gazeta etj.). Duhet të prisnin botimet e tyre në letër, që të mund të hartonin lista dhe më pas t'i porositnim. Por, tani që kemi ndërrmarrë përfshirjen në koleksionet tona albanologjike edhe të materialeve dëgjimore-pamore, seleksioni na është bërë më kompleks pasi përmbajtja e njësisë nuk është më kriteri i vetëm për të realizuar blerjen. Por duhet menduar pak më shumë. A është njësia kompaktibël me pajisjet ekzistuese? A është njësia e zhveshur nga problemet e së drejtës së autorit apo nevojitet një marrëveshje për licensim të drejtë? Pra, zgjedhja kërkon ekspertizë për tematikën, por edhe ekspertizë teknike.

Lindin natyrshën pyetjet: "A është i përkryer koleksioni ynë albanologjik ?" dhe "A bëhet kujdes në plotësimin e tij ?"

Ndonëse në vite është bërë kujdes që koleksionet albanologjike të pasurohen ngahera me materiale të munguara, bibliotekat në Shqipëri hasin pengesa në pasurimin e koleksioneve të tyre me fond albanologjik. Megjithë kujdesin që tregojnë specialistët në përzgjedhjen me profesionalizëm të çdo lloj materiali, madje me një kosto sa më efektive, hasen vështirësi në drejtim të pasurimit të koleksioneve me karakter albanologjik. Ka shumë arsye për këtë. *Së pari,* mungojnë katalogët e botuesve dhe një shpërndarje e organizuar e botimeve. Kjo ndodh si për BKSh ashtu edhe bibliotekat e tjera. BKSh-ja e ka jo të lehtë të informohet për botimet nëpër rrethe, dhe e kundërta, megjithëse BKSh-ja hedh në katalogun elektronik çdo hyrje të re, kjo nuk mjafton. *Së dyti,* komunikimi dhe transporti është i komplikuar. *Së treti,* ka pak librari nëpër rrethe që ofrojnë botime dhe plotësojnë kërkesat e bibliotekave. Është më lehtë të porosisësh libra në Amerikë e Europë, sesa nga një qytet i Shqipërisë në një tjetër, pasi bibliotekarit i mungon si informacioni, ashtu edhe shpërndarja e organizuar e botimeve brenda vendit.

Si mundet që specialisti i bibliotekave me koleksione albanologjike në Shqipëri e Kosovë të mund të ndërtojë një koleksion që të kënaqë nevojat e studiuesit shqiptar e të huaj?

Natyrisht, duke shfrytëzuar të gjitha risitë, sidomos stimulimin e seleksionimit, pasi edhe buxheti për blerje apo abonim i bibliotekës nuk është i lehtë që të sigurohet. Nuk kam ndeshur së paku një bibliotekar në morinë e qindrave që kam takuar, si brenda ashtu edhe jashtë vendit, që të mos jetë ankuar, që të më ketë thënë që biblioteka e tij ka fonde të mjaftueshme për blerje librash. Nëse biblioteka nuk ka buxhet të veçantë për blerje materialesh bibliotekare, ajo nuk mund ta kryejë misionin e saj për zhvillimin e koleksioneve dhe do të ketë impakte negative në koleksionet e tij. Nëse ka një të tillë, duhet bërë kujdes në menaxhimin dhe përdorimin e tij në mënyrë sa më efikase, për të mundësuar të gjitha llojet e materialeve bibliotekare. Absolutisht nuk ka rregulla për këtë gjë. Një gjë është e sigurtë, që, për të

gjithë komunitetin e bibliotekarëve të zhvillimit të koleksioneve, që të gjitha këto ndryshime, risi, dhe zhvillime të reja, kërkojnë kompetenca rë reja,.aftësi të reja, dije të reja, që ata duhet të fitojnë për të përballuar sfidat.

E ardhmja: krijimi i rrjetit të bibliotekave digjitale albanologjike

Koleksionet albanologjike, si pjesë e trashëgimisë kulturore, duhet edhe të promovohen në mjedisin e ri digjital. Le të na shërbejë webografia, ky potencial që na ofron sot bota elektronike, si shtysë për të ideuar mundësira për krijime portalesh a rrjetesh të përbashkëta bibliografike albanologjike, "autostradash" informatike, zhvillime spektakolare të website-ve tona, pasi edhe vetë tema bosht e kësaj konference është "Shkenca e bibliotekave dhe albanologjia". Disa prova i kemi tanimë në duar:

c-ALBANICA, që përfaqëson Bibliotekën Digjitale Albanologjike, tanimë edhe në portalin europian EUROPEANA në linjë/online, që përmban vepra nga koleksioni albanologjik i Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë, prej shekujve XV-XIX, në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të tjera.

BESA, që përfaqëson Bibliotekën Elektronike të Siteve Arbëreshe, që synon krijimin e një katalogu kolektiv në linjë/online me regjistrime bibliografike të fondeve (libra, revista, dorëshkrime, materiale dëgjimore-pamore, burime elektronike etj.) të bibliotekave të komuniteteve të ndryshme shqiptare, që gjenden në Kalabri apo në krahinat e tjera të Italisë, si edhe në rajonin e Ballkanit, me interes albanologjik.

Në epokën e konkurrencës teknologjike, kur përditë flitet e shpresohet për integrime në rrjedhat europiane e botërore, a nuk duhet që edhe bibliotekat tona kombëtare të shtyhen për të ngritur rrjete të përbashkëta informacioni albanologjik? Them se po. Ka ardhur koha që këto rrjete në linjë/online të jenë pjesë e strategjive të bibliotekave kombëtare për të bashkëpunuar dhe për zhvilluar koleksionet albanologjike, si në Tiranë ashtu edhe në Prishtinë. Një projekt i tillë ambicioz është plotësisht në përputhje si me politikat e qeverisjeve aktuale, me programet për integrime të Shqipërisë dhe të Kosovës në rrjetet globale të informacionit, përdorimin e teknologjive të reja në dobi të individëve dhe të gjithë shoqërisë shqiptare, ashtu edhe me rekomandimet e Bashkimit Europian.

Preferoj ta përfundoj me: "Nuk ka asgjë të përhershme përveçse ndryshimit" (Heraclitius). I gjithë komuniteti i bibliotekarëve e di që ndryshimet e vijueshme janë karakteristike për kohën në të cilën ne jetojmë. Sfida të papritura mund të çfaqen përpara nesh në të ardhmen. Por unë jam optimiste sepse efektet e punës së kryer nga bibliotekarët në mbarë botën janë afatgjatatë, duan kohë që të duken. Nuk është edhe aq e lehtë të maten sukseset. Historia vijon... .

Koleksionet albanologjike në BKUK

Adil OLLURI
Berat DAKAJ
Biblioteka Kombëtare
dhe Universitare e Kosovës

Albanologjia është një fushë shkencore që merret me studimin e historisë, gjuhës, letërsisë dhe kulturës shqiptare.

Ajo paraqet dijen me qenësore për shqiptarët, ku jepen të dhëna për frymën dhe shpirtin e kombit tonë. Nga të gjitha studimet që bëhen për shqiptarët dhe mbi shqiptarët, studimet albanologjike janë më dominueset. Ato, njëkohësisht, kanë krijuar dhe po krijojnë opinionin e përbotshëm dhe vendor për gjuhën, kulturën dhe identitetin e shqiptarëve.

Shënimet e para mbi shqiptarët, që mund të quhen si vrojtime parashkencore për popullin tonë, apo dokumente të para albanologjike, kanë filluar dhe janë bërë nga të huajt, albanologët joshqiptarë, duke filluar me "Fjalorthin" e Arnold von Harfit, dokument i shënuar mes viteve 1496-1499. Pastaj, me "Letrat" e filozofit të madh gjerman, Lajbnicit, drejtuar gjuhëtarit më me nam të asaj kohe në Europë, M. V. La Croze (1705-1715), si dhe me librin e Johan Thunman mbi popujt e lindjes "Hulumtime në historinë e popujve të Lindjes". Ndërkaq, faza e dytë, që mund të cilësohet edhe si fazë shkencore e studimeve albanologjike, po ashtu fillon në gjysmën e dytë të shekullit XIX, me albanologët e huaj, ku vlen të përmendim Johan George von Hahn me librin "Albanische studien" (1854), Gustav Meyer me librin "Albanische Grammatik" (1883), studimet albanologjike të Franc Baron Nopsca (1877-1933), të Milan Shuflaj, Norbert Jokl, si dhe me librat e Edit Durham "The burden of the Balkans" (1905) dhe "Albania and Albanians: selected articles and letters 1903-1944". Ndërsa nga albanologët joshqiptarë të ditëve tona mund t'i përmendim: Aleksandër Stipçeviq, Noel Malcolm, Robert Elsie, Oliver Jens Schmitt, Hans Joachim Lanksch, Kazuhiko Jamamoto, Florian Kienzle etj.

Studimet albanologjike të bëra nga mendimtarët dhe studiuesit shqiptarë kanë filluar në shekullin XX, ku ndër të

albanologët më të rëndësishëm janë: Faik Konica, Branko Merxhani, Krist Maloki, Eqrem Çabej, Arshi Pipa, Selman Riza, Shaban Demiraj, Rexhep Qosja, Ibrahim Rugova, Aurel Plasari, Primo Shllaku, Bardhyl Demiraj etj.

Në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës fondi i studimeve albanologjike mund të gjendet në disa sektorë apo departamente të këtij institucioni më të lartë bibliotekar në vendin tonë. Pra, këto studime mund të gjenden në Departamentin e Koleksioneve të Veçanta, në të cilin i kemi librat e rrallë dhe të vjetër, që e begatojnë këtë bibliotekë. Po ashtu, studimet albanologjike në BKUK mund të gjenden edhe në sektorin e doktoratave, magjistraturat e master, si dhe në Bibliotekat legatë apo personale, siç është ajo e Krist Malokit dhe ajo e Fehmi Aganit, që gjenden brenda BKUK-së. Gjithashtu, studime albanologjike, në institucionin tonë, mund të gjenden edhe në fondin e librave serialë apo të zakonshëm, ku mund të hasen sidomos studimet të tilla të bëra nga gjysma e dytë e shekullit XX dhe dekada e parë e shekullit XXI.

Nëse flasim për llojet e studimeve albanologjike, të cilat gjenden në BKUK, atëherë mund të themi se dominojnë studimet letrare, studimet gjuhësore dhe studimet historike, për të vazhduar me studimet kulturologjike, si për identitetin, kombin, etninë, flamurin, studimet etnologjike, studimet muzikologjike, studimet sociologjike e politikologjike etj.

Ndër librat kryesorë që kanë lënë gjurmë në fushën e albanologjisë dhe të cilat gjenden në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, mund të përmendim:

- Gustav Meyer, "Albanische Grammatik" Leipzig, 1888
- Johan George von Hahn, "Shënime permi shkrimin e vjetër pellazgit", përktheu Eqrem Bej Vlora, Stamboll, 1910
- M. Edit Durham, "The burden of the Balkans"
- Mehdi Frashëri, "Liga e Prizrenit dhe efektet diplomatike", Tiranë, 1927,
- Tadeusz Czekalski, "Albania 1920-1939",
- "The memoirs of Ismail Kemal Bey", with preface by William Morton Fullerton
- Constandine A. Chekrezi, "Albania, past and present", New York, 1919
- A. Siljani, "Besa, feja e shqiptarvet te vjeter", Sofje, 1907
- "Kanuni i Lekë Dukagjinit", permbledh e kodifikue prej At Shtjefan Konstandin Gjeçovit, Shkodër, 1933 etj.

Në BKUK bëjnë pjesë edhe një sërë revistash, të cilat për nga natyra dhe misioni i tyre bëjnë pjesë në fondin e koleksioneve albanologjike. Ndër revistat e tilla që vlen t'i përmendim janë:

- "Hylli i Dritës" (revistë e përkohshme françeskane, 1913, Shkodër, kryeredaktor i parë i saj ishte At Gjergj Fishta)

- "Leka" (revistë e etërve jezuit, Shkodër)
- "Kalendari kombiar" (1907, Sofje)
- "Përpjekja shqiptare" (Revistë e përmuajshme kulturore, drejtor Branko Merxhani, 1936)
- "Fryma" (e përmuajshme letrare-kulturore, 1944)
- "Jeta e Re" (revistë letrare, themelues dhe kryeredaktor i parë i saj ishte Esad Mekuli, 1949)
- "Fjala" (revistë mujore letrare, Prishtinë, 1968)
- "Shoshi" (revistë mujore për kulturë, Prishtinë, 1998) etj.

Lexuesi i interesuar për këto fonde albanologjike në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës mund t'i kërkojë ato përmes katalogut elektronik të bibliotekës sonë, por edhe përmes skedarëve manualë, të cilët po ashtu mund t'i ndihmojnë lexuesit në kërkimin e tij. Ky lexues, librat e fondit serial të koleksioneve albanologjike mund t'i lexojë edhe në sallat e leximit të bibliotekës sonë, ndërsa librat e rrallë dhe të veçantë, si dhe doktoratat, magjistraturat e masterit, ai mund t'i lexojë vetëm në prani të punonjësit gjegjës bibliotekar.

Format e pasurimit dhe reflektimi i tyre në albanologji

Fatime MILLAKU
Besnik GASHI
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

Hyrje

Tradita e mëhershme e zhvillimit të koleksioneve në BKUK është përcjellë me shtrëngesa, kufizime, kontroll e censurë politike e ideologjike. Për çlirimin e koleksioneve nga ky ngatërrim, është dashur që BKUK-ja të përcaktojë plane për zhvillimin e pasurimin e koleksioneve, e si rrjedhojë edhe të fondit albanologjik - si vlera historiko-dokumentare e shkencore të shkruara në gjuhën shqipe dhe të huaj, që konsiderohen të një rëndësie të veçantë.

Pra, BKUK-ja ka trashëguar brenda vetes një fond me diversitet kulturor dhe gjuhësor. Ende, as tash, nuk mund të themi se fondi albanologjik përbën pjesën më të rëndësishme të koleksioneve bibliotekare, përderisa koleksionet e BKUK-së, edhe pas 10 vitesh, dominohen nga fondi kryesisht në gjuhët sallave, duke patur parasysh se për 50-60 vite ky koleksion ka qenë shumëgjuhësh e shumëkulturash, duke dominuar koleksioni me burim sllav, ku gjatë më shumë se 50 viteve është grumbulluar çdo titull i njësive të tjera federative në kuadër të Jugosllavisë.

Mund të themi se frika dhe represioni ideologjik në Kosovë nuk e ka prekur vetëm librin albanologjik në bibliotekat – si institucione të organizuara të shtetit, (ku është konsideruar punë e ndaluar nëse një bibliotekar ka marrë përgjegjësinë për të pasuruar fondit albanologjik), por edhe bibliotekat private, të cilat nëpër etapa të caktuara të represionit të madh janë konfiskuar nga policia, ndërsa pronarët e tyre janë burgosur si nacionalistë e irredentistë. Në anën tjetër, shumë nga njerëzit i kanë fshehur librat nën dhé, për t'i ikur represionit, duke u kalbur e shkatërruar ato. Në kohën e luftës, shumë biblioteka u shkatërruan dhe u dogjën, me to u shkatërrua edhe fondi albanologjik i tyre. Ndërsa tash, ende kemi mungesën e një strategjie kombëtare për zhvillimin e fondeve dhe të bibliotekave, duke pasur një mbështetje financiare të zbehtë.

Çfarë dhe kur mund të bëhen politika të qëndrueshme për të mundësuar pasurimin sa më të plotë të bibliotekës me tituj

nga fondi albanologjik? Tashmë, me gjasë, do të duhej të detyrohemi t'i gjejmë modalitetet sesi ta plotësojmë boshllëkun e mungesës së këtij fondi, duke pasur parasysh misionin e një biblioteke kombëtare.

Format e pasurimit dhe sfidat e zhvillimit të fondit albanologjik

Ekzemplari i detyrueshëm, si një prej formave të pasurimit të koleksioneve bibliotekare, do të ishte më reprezentuesja e më përfaqësuesja, që do të ndërtonte përkatësinë dhe përhershmërinë e vlerave kulturore, arsimore e shkencore nacionale (shqiptare), sikur ne të ishim një shtet etnik i vetëm - Shqipëri, Kosovë e pjesë të ndara të kombit. E, meqë jemi të ndarë, ky matës dhe kjo vlerë kulturore unike, është i shpërndarë në po aq shtete ku shqiptarët realizojnë në mënyrë përfaqësuese veprimtarinë e tyre botuese e intelektuale. Si mund të flasim, ta zëmë, për një fond albanologjik reprezentues e gjithëpërfshirës në Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë, nëse në të nuk arrihet të përfshihen botimet e Kosovës dhe të vendeve të tjera, ose anasjelltas në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës.

Në këtë kontekst, problemet që i ka BKUK-ja për ta pasur sa më të plotë fondin albanologjik janë politike (ideologjike) e historike. Një Kosovë e ndarë, e cila ka jetuar në një represion permanent kulturor, duke e diskriminuar atë në kuptimin e realizimit të identitetit të saj nacional: një veprimtari botuese e kontrolluar nga shteti; e izoluar nga Shqipëria në kuptimin e qarkullimit të librit e të vlerave nacionale, me një dëmtim të fondeve - sidomos gjatë viteve '90 të shekullit të kaluar etj., e ka bërë të pamundur që fondi albanologjik të zhvillohej ashtu si do të duhej.

Të kujtojmë se BKUK-ja ka pasur një revizion që e ka përfunduar para 6 vitesh, në të cilin, gjatë leximit dhe krahasimit të skedave të katalogut topografik përballë njësive - titujve në raftet e materialeve, janë konstatuar humbjet që lidhen me periudhën e pas Luftës së Dytë Botërore deri në vitin 1999. (Ndërsa që ende nuk është bërë një bazë e të dhënave se sa dhe cilët tituj - botime të Kosovës janë humbur).

Për boshllëkun që ka BKUK-ja për ta plotësuar këtë fond, është në kërkim të informacionit e të materialeve të botuara, të rigjejë ato që kanë humbur dhe ato që nuk i ka ende brenda koleksione të veta.

Përpjekjet lidhen me kapacitete që mund t'i aktivizojë biblioteka për të siguruar titujt e humbur gjatë viteve 1945 – 1990, si dhe për të plotësuar boshllëqet gjatë viteve 1990 – 1999, kur shqiptarët e Kosovës janë dëbuar nga institucionet dhe e drejta për të punuar në to.

Gjatë viteve '90-të, në kohën e shpërbërjes së një shteti federal dhe fundit të një ideologjie komuniste, Kosova fundin e këtij ndryshimi e priti nën një okupim ushtarak e policor të masave të dhunshme serbe; ajo nuk arriti të hyjë nëpërmjet një procesi normal në ndryshimet ekonomike e politike, që përcillen nëpërmjet një pluraliteti mediatik e editues – sepse ajo ishte e okupuar. Në këtë ndalim e represion, veprimtaria botuese në Kosovë u realizua

e pazyrtarizuar. Nuk dihej çfarë botohej, por dhe tifujt që botoheshin nuk mund të hynin në BKUK, për shkak të masave të dhunshme.

Në një treg të shkapërderdhur të botimeve, nuk pati kush të mbajë kontroll bibliografik të botimeve që bëheshin në Kosovë. Botuesit materialin e botuar e shitnin apo e shpërndanin, pa ruajtur ekzemplarë të botimeve të tyre, ndërsa nuk kishte ndonjë kontroll zyrtar as nga institucionet paralele që atëherë shqiptarët në Kosovë i kishin formuar.

Në këtë pikë, pas luftës problemi nuk mund të shihej vetëm me të mësuarit e pasojës, por edhe të brengosjes - të prekjes nga një pagjumësi, për të kërkuar se si ta funksionalizojmë natyrën e aktivitetit kreativ, për të korrigjuar këtë boshllëk.

Përpjekjet e BKUK-së për të kompensuar këtë boshllëk pas luftës, ishin të vështira meqë nuk kishte adresë të saktë ku mund të merret informacion bibliografik e as materialet e botuara.

Në një përpjekje të mundimshme për t'u rimëkëmbur, gjatë periudhës 1999 - 2002 nuk ishte hyrë asnjë titull - ekzemplar i detyrueshëm në BKUK. Zhvillimi i ngadalshëm i infrastrukturës ligjore, që do të përcaktonte qartë veprimtarinë botuese dhe detyrimet ligjore që rrjedhin nga kjo, si dhe detyrimet që ka BKUK-ja, si institucion kryesor bibliotekar i Kosovës, e vështirësuan deri në bllokim pranimin e ekzemplarit të detyrueshëm. Deri në vitin 2003 botuesit e botimeve më të rëndësishme kosovare, botimet e veta ia kanë dorëzuar BKUK-së vetëm nëpërmjet blerjes, që është bërë pa ndonjë sistem dhe planifikim të menduar mirë. Nga viti 2003, BKUK-ja monitoron veprimtarinë botuese, dhe nga atëherë në secilin vit është rritur dukshëm numri i titujve – ekzemplar i detyrueshëm.

E ballafaquar me vështirësi për sigurimin e ekzemplarit të detyrueshëm, Departamenti për Zhvillimin e Koleksioneve në kuadër të BKUK-së, pati realizuar një sërë aktivitetesh informuese, komunikim me botues kosovarë, që mundësoi krijimin e një bazë të të dhënave të qarta për botuesit dhe botimin e titujve nga ta.

Në këtë kontekst, edhe tash pas dhjetë vitesh, vijojnë të jetë shumë aktuale pyetjet: a mund të jetë i kënaqur një përdorues (studiues) me atë që i ofrohet nga pjesa e fondit albanologjik – që në BKUK, është i shkrirë në fondin e përgjithshëm?; a mund ta gjejë studiuesi në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës njërin nga librat themelor në fushë të albanologjisë?; si do ta pajtonim një studiues se titulli në fjalë (titull që mund të shenjohet si njëri prej më të rëndësishmëve në kuptimin albanologjik) nuk gjendet në fondin e BKUK-së.

Më shumë se t'i japim mundësi përdoruesit të na sfidojë - nëse do t'i themi: *çfarë dëshironi nga titujt e një fushe përkatëse të studimeve albanologjike*?, do të kalonim më mirë po qe se i drejtohemi: *a mund të provojmë të gjejmë ndonjë titull nga ajo fushë përkatësie e studimeve albanologjike*'. Pra, bibliotekari referal më përballueshëm do ta kishte që t'i rekomandonte përdoruesit ndonjë libër nga fondi i albanologjisë, se sa ta priste kërkesën e përdoruesit se çfarë kërkon ai. Kështu, midis *dëshirës* dhe *mundësisë* së një bibliotekari referal, për t'i ofruar

një përdoruesi shërbim të kënaqshëm, ekziston një paqartësi emocionale e thellë.

Pra, në një situatë kur për fondin albanologjik nuk janë bërë statistika dhe analiza të thella se sa dhe çfarë ka brenda këtij fondi, edhe pse dihet shenjueshëm se ai është i varfër, bibliotekari që gjendet para përdoruesit sy më sy, vështirë e ka të ndjehet rehat. Kjo i ka kufizuar mundësitë e bibliotekës për një shërbim të kënaqshëm ndaj përdoruesit. Bibliotekari ynë vijon të evidentojë pa pushuar mungesën e titujve që janë porositur nga përdoruesi me interesime albanologjike.

Pasurimin me tituj nga fondi i albanologjisë, në mënyrë të veçantë e kanë ndihmuar format e tjera të pasurimit, si: shkëmbimi, blerja dhe dhurata.

Ne mund të themi se një bashkëpunim i frytshëm në planin e shkëmbimit (fjalën shkëmbim në këtë kontekst mund ta përdorim sa për t'i dhënë jetë veç fjalës, sepse këtu nuk janë bërë pazare se çfarë më jep ti, që të të jap unë), ka funksionuar me Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë, e cila është treguar shumë bujare me dhënien e një mori titujsh të rëndësishëm, që tashmë janë bërë pjesë e koleksionit të rrallë në BKUK dhe që përfshijnë periudhën e botime që nga koha e Rilindjes Kombëtare e këndej.

Ky bashkëpunim i këtyre dy bibliotekave kombëtare do të mund të shpërfaqë një faqe tjetër të kontributit të dyanshëm - duke ndihmuar njëra-tjetrën në mungesat që kanë në fondin albanologjik, ku secila nga këto dy biblioteka jep diçka, për t'i plotësuar mungesat njëra tjetrës. Ky do të përbënte një akt të rëndësishëm dhe të veçantë për plotësimin e një pjese të shtresës kulturore albanologjike që mungon te njëra po te tjetra.

Ndërsa, kur është fjala te blerja, mund të themi se që nga viti 2004, për çdo vit janë bërë blerje të qindra titujve me vlerë të rëndësishme albanologjike me tematikë e kronologjikë të gjerë, si: memuare e udhëpërshkrime të të huajve për shqiptarët, biografi politike, studime antropologjike, studime politike, sociologjike e gjuhësore, duke përfshirë botime midis shekujve XVI - XX.

Përveç titujve në gjuhën shqipe, janë blerë edhe shumë tituj në gjuhë të huaj, me vlerë të veçantë. Nxitja ka qenë e motivueshme – fondit të BKUK-së i ka munguar ky koleksion; lexuesi i ka pasur të kufizuara referencat, por dhe interesimet se çfarë është shkruar dhe shkruhet për shqiptarët nga të huajt. Tashmë janë hyrë libra, (të mbërthyer nga nxitjet dhe kërkesat e përdoruesve për këtë tip të literaturës), që nuk do t'i shpëtojnë vëmendjes së lexuesit të gjerë, dhe jo vetëm specialistëve të dijes.

Përveç blerjes, shumë tituj janë dhuruar nga individë dhe autorë të rëndësishëm të kulturës shqiptare. Janë të njohura dhuratat nga: Shaqir Kastrati, Hasan Efendi Nahi, Krist Maloki, Fehmi Agani, si dhe dhurues të tjerë të bibliotekave familjare apo personale, që ofrojnë tituj dhe ekzemplarë që janë me sasi të kufizuar, nga ky fond.

Burimet e informacionit për librin dhe qasja jonë ndaj tyre

Në një situatë kur në BKUK bëhen përpjekje për të ndërtuar një bazë të dhënash, që do të na japin mundësinë e kërkimit e të gjetjes së formave për të zhvilluar fondin albanologjik, është e nevojshme të dimë të bëjmë përshkrimin dhe indeksimin e burimeve, prej nga mandej mund të sigurohet mundësia për mbledhjen e titujve nga fondi albanologjik.

Në politikat e qarta për pasurimin e fondeve ku kemi parasysh këtu stafin e angazhuar të bibliotekës, si: bibliotekarët nga shërbimi i pasurimit të fondeve, që bëjnë klasifikimin dhe përzgjedhjen e titujve (nga blerja, dhurata apo shkëmbimi), apo bibliografët, që bëjnë përpunimin e të dhënave bibliografike dhe i krahasojnë ato me njësitë në katalogun e bibliotekës, janë të dhënat nga bibliotekarët referalë, që për çdo ditë kompletojnë listat e titujve që mungojnë në fondin e bibliotekës, që nxisin për një punë më dinamike për të plotësuar këto boshllëqe. Përdoruesit në total - kër-kesat e tyre të shtuara për fondin albanologjik. Kujtojmë këtu numrin e shtuar të të interesuarve për kërkime albanologjike, si nga vendësit po ashtu edhe nga të huajt - studiues, apo të tjerë në misione diplomatike në Kosovë, janë duke identifikuar qartë aktualitetin e titujve dhe, ndoshta, edhe vlerën e tyre. Një libër i palexuar nga lexuesi, për 50 vite, vështirë të bëhet pas 50 viteve libër që do t'u shërbente nevojave themelore të lexuesve të ardhshëm. Nuk po flasim për librin e ndaluar – për "jetën" e librit në ideologji, por për librin që ka bërë jetë normale - pa i shpallur "luftë" ideologjisë. Pra, e para e punës, dua të them në këtë kontekst, se duhet të mundohemi të plotësojmë këto kërkesa të përdoruesve, që më pastaj të hapet fronti i një beteje të gjatë për ta kompletuar sa më shumë fondin albanologjik me tituj aktualë dhe ata retrospektivë. Të mundohemi ta gjejmë titullin që na mungon, ta sjellim atë para syve tanë, ta bëjmë të prekshëm atë; me këtë do të dëshmojmë përkushtimin tonë. Pra, sfidat janë teknike dhe profesionale se si të garantojmë një grumbullim të frytshëm të fondit albanologjik.

Nuk do të jemi rehat para përdoruesit (studiuesit), i cili është nisur që t'i marrë nga ne dhjetë apo më shumë libra, ndërsa që do të kthehet me 2-3 prej tyre, apo pa asnjë.

Mund të jetësojmë çdo performancë të mundshme për pasurimin e fondit nga fusha e albanologjisë, por duke ia përshkruar vetvetes një rregull, pra limitin, duke gjeneruar kështu aktiviteti ynë nga një aktivitet i vogël dhe i thjeshtë për sigurimin e një titulli, në një aktivitet kompleks, që mbulon gjithë fushën e kërkimit dhe grumbullimit të materialit nga fusha e albanologjisë. Pas një serie hapash të kufizuar, ne do të mund të arrijmë deri te zgjidhja: sigurimi i informacionit, ta zëmë, një titull - kush, ku e kur është botuar, beteja e dytë është si të gjendet kopja fizike e saj. Pra, duke u strukturuar në atë mënyrë në të cilën bibliotekari mund ta selektojë zgjedhjen e informacioneve fizikisht të lëvizshëm, p.sh. ku mund ta gjejmë librin në fjalë.

Ne tashmë jemi të lirë që të lëvizim. Askush nuk e ndalon askënd, pa marrë parasysh se në cilën pozitë punon në bibliotekë, që të mund ta gjejë një titull që i mungon bibliotekës. Ne jemi të detyruar ta pranojmë fatin dhe të kuptojmë se nuk jemi në gjendje ta plotësojmë gjithë boshllëkun e lërë në vite, por të qenit në një shtet – në një Kosovë të lirë, na lejon që të praktikojmë lirinë dhe kreativitetin, për të jetësuar projektin për zhvillim të fondit albanologjik. Për këtë është e domosdoshme të arrihet një nivel përgjegjësie veprimi moral e intelektual.

Pas një biblioteke kombëtare, siç jemi ne, do të duhej të qëndronte fuqia e reproduktimit të informacionit, e inkurajimit që na jep zbulimi i këtij informacioni – jo vetëm cilin titull e kuptuam të jetë botuar dhe ku mund ta gjejmë, por edhe atë që tashmë i takon së kaluarës dhe nuk mund të sajohet ndryshe pos nëpërmjet një kërkimi kreativ.

Me qëllim që të kuptojmë se si funksionon procesi i plotësimit të fondit albanologjik, - të tashmit e atij retrospektiv, - ne kemi parë mundësitë dhe kufizimet që na dalin për të realizuar këtë; hutesat dhe ndërlikimet që shkaktohen gjatë përzgjedhjes së titujve.

Ta marrim shembull autorin Eqrem Çabejn - në gjuhësi, nga librat e tij mund ta definojnë se cilët libra kanë relevancë shkencore për studimet etimologjike në gjuhësinë shqiptare, duke u mbështetur në autorë dhe tituj që kanë qenë bazë referençialiteti të punës së tij, dhe pastaj ata tituj t'i kërkojmë, e nëse ata tituj prapë kanë referencë tituj të tjerë, të shkojmë t'i kërkojmë të tjerët tituj. Në të njëjtën mënyrë, veçantitë e këtyre kërkimeve mund të jenë të shpërfaqura kështu edhe në fushat e tjera të albanologjisë.

Sistemi është i kufizuar, librat (titujt) nënkuptueshëm pastaj fizikisht janë të prekshëm, në kuptimin e asaj që ne mund të lundrojmë në një lloj lëvizjeje në hapësirë e kohë të përcaktuara të botimeve. Në këtë kuptim, sigurisht se të gjitha librat përfytyrueshëm janë përbrenda një libri, por nënkuptueshëm se mund të jenë të ndryshëm (në kuptimin e ngushtë të një fushe) – duka na mundësuar të ndërtojmë një univers të mbyllur.

Ndërsa përkundrejt tekstit, nëse ne themi p. sh. se e kemi në dorë librin: "Bibliografi për historinë e alfabetit të gjuhës shqipe : 1844-2008", na lejohet neve një listë e shumë librave apo artikujve, që, ta zëmë, që të gjithë janë organikë - për një problem (fushë) të caktuar.

Por, nëse definitivisht e hartojmë listën, duke përzgjedhur tituj nga e njëjta bibliografi - atëherë ne e kemi përjashtuar një titull dhe e kemi përzgjedhur një tjetër mbi një gjykim: ose të pranisë fizikë të njërit nga këta tituj që janë hyrë rishtas në bibliotekë, ose i njëjti titull tashmë është ribotuar, ose i njëjti është vlerësuar si shumë i rëndësishëm të jetë në fondin albanologjik.

Sot është e mundur, dhe ne e bëjmë këtë, kërkimin e informacionit në Internet për tituj të rëndësishëm, në fushë të albanologjisë, ndërsa që sa është përparësia në shumësinë e informacionit, ballafaqohemi me vështirësinë për ta përpunuar këtë stuhi të papenguar të informacionit e të komenteve pa fre për vlerat e një botimi.

Përfundim

Departamenti i Zhvillimit të Koleksioneve Bibliotekare në BKUK vijon të preokupohet me hartimin e strategjisë për zhvillimin e koleksioneve bibliotekare me fond albanologjik, në përputhje me informacionin që "e kullon" për titujt e botuar tash dhe në retrospektivë. Ky departament ka ndërtuar një bazë të të dhënave për botues, shtypshkronja, universitete, institucione hulumtuese, që botojnë materiale me përmbajtje albanologjike; pra harton lista të titujve, vendin ku gjenden ato dhe çmimin e tyre.

Pra, po flasim për një rrjet të dhënash potencialisht funksional të kërkimit, prej ku mund të vlerësohet çdo njësi bibliografike, në bazë të llojit të materialit bibliotekar, përmbajtjes dhe rëndësisë.

Ndërtimi i këtij sistemi kombëtar të pasurimit (krijimi i një rrjeti të kontrollit të informacionit për gjithë materialin e botuar dhe të shtypur në Kosovë) synon krijimin e mundësive për mbledhjen e gjithë materialit bibliotekar - si pjesë trashëgiminë kulturore të Kosovës.

Ndërsa që po e përfundojmë këtë kumtesë për të vërë në pah, se sa është i rëndësishëm, gjithashtu, hartimi i një platforme të përbashkët të bashkëpunimit me Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë, për ta ndihmuar atë në zhvillimin e fondit albanologjik, duke pasur në dijeni detyrimin, por dhe vullnetin, që ka Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës për pasurimin e fondit albanologjik.

Sistemet bibliotekare me burim të hapur, mundësi për krijimin e burimeve elektronike

Behije LUGA
&
Enilda KOLA

Hyrje

- Zhvillimi i teknologjive të fundshme, bazës e madhe e informacionit në multimedia dhe në formate të tjera digitale, përdorues të zotë me njohuri të mira teknologjike, si dhe zgjerimi i "hendekut digjital" do të thotë që bibliotekat në përgjithësi dhe bibliotekarët në veçanti, po ballafaqohen me sfidën e madhe të revolucionit të informacionit
- Bibliotekat tona duhet ti përgjigjen këtij zhvillimi me qëllim që të vazhdojnë të mbeten të lidhura me shoqërinë, të cilës i shërbejnë. Por, bibliotekat dhe bibliotekarët duhet së pari të pajisen me njohuri të domosdoshme dhe aftësi përpara se ato të merren me këtë sfidë të madhe

…Hyrje

- Duke kuptuar rolin e rëndësishëm që kanë sistemet bibliotekare në planifikimin dhe zbatimin e projekteve të automatizimit të bibliotekës është domosdoshmëri që të kemi më shumë njohuri rreth këtyre sistemeve
- Në vijimësi kësaj kumtese do të fokusohemi në sistemet bibliotekare me burim të hapur, të cilët janë komponentë thelbësor në automatizimin e bibliotekës, duke sjellë edhe disa mundësi zbatimi për rrjetin e bibliotekave tona.

Çështjet kryesore

Hyrje
- Objekti, qëllimi
- Përcaktimi i sistemeve bibliotekare me burim të hapur
- Standardet që mbështeten nga SB me burim të hapur
- Zgjedhja e programit me burim të hapur për ndërtimin e katalogut elektronik
- Zgjedhja e programit me burim të hapur për ndërtimin e objekteve digjitale
- Prezantimi i Bibliotekës Digjitale Albanologjike të BK
- Përfundime

Hyrje …

Teknologjia e informacionit dhe komunikimit (TIK) ka hapur sot një perspektivë krejtësisht të re. Bibliotekat janë siguruesit kryesorë të informacionit të shoqërisë dhe janë ndër përdoruesit e parë të teknologjisë digjitale në lidhje me katalogimin dhe menaxhimin e informacionit

… Hyrje

- Sot bibliotekat në mbarë botën janë duke realizuar fuqishëm digjitalizimin e koleksioneve të tyre dhe në veçanti materialet e rralla dhe unike të trashëgimisë kulturore
- Burimet kulturore, shkencore publike dhe administrative tashmë po publikohen, shpërndahen dhe aksesohen gjithnjë e më tepër në formë digjitale
- Digjitalizimi siguron ruajtjen e kësaj trashëgimie kulturore si dhe aksesin e gjerë për përdoruesit

….Hyrje

Interneti, portalet dhe shërbimet në rrjet kanë ndryshuar shumë funksionet dhe fokusin e bibliotekave

Ndryshime të ndodhura në mjedisin bibliotekar

Akses më i madh në burime të shumëllojshëm të informacionit,

Rritje e shpejtësisë në marrjen e informacionit,

Teknologji në ndryshim të pandërprerë.

Përdorimi i standardeve në fushën e bibliokonfigurimit si dhe të standardeve teknike për hardin dhe softin

…Ndryshime të ndodhura në njedisin bibliotekar

- Kualifikim i vazhdueshëm i përdoruesve dhe personelit bibliotekar
- Investime të ndjeshme financiare për teknologji

Objekti, qëllimi

Të ndihmoje që bibliotekat tona, duke përfituar nga zhvillimet e TIK-ut, të rrisin vepnimtarinë e tyre dhe shërbimet e informacionit ndaj përdoruesve.

- Zhvillimi i sistemeve bibliotekare me burim të hapur do të sjellë një përmirësim të dukshëm në krijimin e katalogëve elektronikë, organizimin e koleksioneve digjitale dhe botimin e tyre në Internet dhe në CD/DVD në formë plotësisht të kërkueshme nepermjet metadatavet të cilat janë të domosdoshme në mjedisin digjital.
- Të krijojë, ruajë dhe s-gurojë burime elektronike në ndihmë të aktiviteteve shkencore, arsimore dhe kulturore.
- Bibliotekat tona së shpejti të kooperojnë dhe të marrin pjese ne sistemet e burimeve të përbashkëta te informacionit midis bibliotekave europiane

Sistemet e menaxhimit bibliotekar

Sot ka një shtrirje më të gjerë të sistemeve të menaxhimit Ato përfshijnë:

- të gjitha funksionet tradicionale të bibliotekës,
- akces në Internet dhe në baza të dhenash me tekst të plote,
- akces në sisteme bibliotekare dhe rjete të tjere,
- akces në depozitues imazhesh, biblioteka digjitale etj.

Misioni i automatizimit

- ***Akcesi;***
- ***Kooperimi;***
- ***Standardet dhe administrimi i tyre;***
- ***Menaxhimi.***

Akcesi

Përfshin:

- përmirësimin e akcesit në burimet e informacionit, që nuk i kanë bibliotekat;
- përmirësimin e akcesit në burimet e bibliotekave.

Kooperimi

Përfshin:

- të dhëna bibliografike të përbashkëta, duke kataloguar më pak në mënyrën e dikurshme tradicionale dhe për të krijuar katalogët përmbledhës;
- shfrytëzim të përbashkët burimesh;
- zhvillim të koleksioneve të përbashkëta për të pakësuar dublikimin e burimeve ndër biblioteka.

Standardet

Automatizimi i bibliotekës varet shumë nga standardet e përshkrimit, organizimit dhe paraqitjes së dokumentave, si dhe nga standardet e harrdit, softit dhe të telekomunikimeve që mbështesin sistemet.

Ka dy lloje standardesh:

- Standarde bibliografike
- Standarde teknike.

Disavantazhet e automatizimit të bibliotekës

- Shpenzime fillestare dhe në vazhdimësi;
- Trajnim i vazhdueshëm i stafit;
- Vjetërimi (dalja nga përdorimi) i harduerit dhe softuerit;
- Sistemet nuk janë të përjetshëm (përdorimi i standardeve është kusht për kompatibilitetin dhe migrimin në të ardhmen);
- Hardi dhe softi zgjasin disa vjet, ndersa të dhenat zgjasin përjetësisht.

Por qe ja vlen !!!!!

- Në këto pak vite të fundit bibliotekat tona janë ballafaquar me një realitet të ashpër, në të cilin ato kanë humbur përdoruesit dhe pozicionin e tyre si burimi parësor i informacionit
- Ne perpjekje për të permiresuar shërbimet e bibliotekes, duke qene deshmitare të një numri të madh sistemesh dhe mjetesh informacioni per biblioteka te modernizuara, ka shume nevoje per kerkimin dhe zbulimin e këtyre mjeteve.

Konferenca Kombetare e Bibliotekarisase

Sfida kryesore e bibliotekave është

FINANCIMI !!

- Kosto fillestare e automatizimit dhe e ndërtimit të koleksioneve digjitale është e lartë.
- Infrastruktura e TIK-ut (harduer, softuer, rrjete, internet etj.).
- Vazhdimësia është element i domosdoshëm.

Konferenca Kombetare e Bibliotekarisase

A ka ndonjë zgjidhje për të filluar bibliotekat tona automatizimin, dhe si fillim:

ndërtimi i katalogut elektronik ,
bazat e katalogut përnibledhës,
hedhja e katalogut elektronik ne Internet,
krijimi i burimeve digjitale me përnibajtje albanologjike.

Konferenca Kombetare e Bibliotekarisase

- Po, dhe është shumë optimiste

Konferenca Kombetare e Bibliotekarisase

- Bota e TIK-ut ndryshon me shpejtësi Teknologjitë e Reja dhe me to mundësi të reja vijnë dhe shkojnë me shpejtësi gjithnje ne rritje
- Lëvizja për Softuerin me Burim të Hapur/të Lirë (Free Open Source Software – FOSS) është një zhvillim që luhet sot para nesh. Ajo ofron shumë mundësi për institucionet qeveritare të sektorit privat dhe edukativ.
- Ato organizata qe i perdorin ne menyren e duhur kane shanse të fitojnë shumë, ndërsa ato, qe dështojnë të përfitojnë prej tij, mund të mbeten mbrapa ne krahasim me organizata të ngjashme

Konferenca Kombetare e Bibliotekarisase

- Iniciativat për lëvizjen drejt Sistemeve të Hapura kanë sjellë mundësi të papara më parë edhe për bibliotekat që të ndryshojnë tabilonë e tyre dhe të bëhen pjesë e shoqënsë së informacionit.
- Nese do të vazhdojme të presim, do të vazhdoje te rritet gjithnje e me shume "hendeku ne akcesin e informacionit" midis bibliotekave tona dhe bibliotekave të botës

Konferenca Kombetare e Bibliotekarisase

Softuerë me burim të hapur (FOSS) ??

Konferenca Kombetare e Bibliotekarisase

Ç' është softueri me burim të hapur/të lirë? Free/Open Source Software (FOSS)

Programet FOSS janë programe, licensa e të cilëve u jep përdoruesve ***lirinë*** të ekzekutojnë, ***të ndryshojnë*** dhe të permirësojnë programin si dhe ***të rishpërndajnë*** kopjen ose origjinalin ose programin e modifikuar (pa qenë nevoja të paguajnë zhvilluesit e mbarahem). Kjo realizohet në mënyrë publike dhe bashkëpunuese

(Wikipedia)

Konferenca Kombetare e Bibliotekarisase

Veçoritë e softuerit me burim të hapur/të lirë…

Lëvizja FOSS bazohet në tre shtylla "të hapura":

- *Burim i hapur;*
- *Standarde të hapura;*
- *Përmbajtje e hapur.*

….Veçoritë e softuerit me burim të hapur/të lirë

- Liria e ekzekutimit të programit për nevoja të ndryshme;
- Liria për të studiuar programin, dhe përshtatja e tij për nevoja lokale;
- Liria e rishpërndarjes së kopjeve për të përfituar të ijerët nga softueri;
- Liria për të përmirësuar programin dhe publikimi i versionit të përmirësuar në publik duke mundësuar përfitimin e komunitetit.

(The Free Software Foundation)

Nevoja për softuerë me burim të hapur

- Kosto e SMIB (ILMS) të pronësuar është shumë e lartë.
- Zhvilluesit komercial nuk e japin kodin e burimit.
- Biblioteka nuk ka kontroll mbi softuerin.
- Investimi për SMIB të pronësuar kurrë nuk ka fund.

Sisteme bibliotekare me burim të hapur :

- MicroLCS,
- Emilda
- Evergreen
- FireFly
- GNUTeca
- Avanti
- Greenston
- Koha
- OpenBiblio
- phpMyLibrary
- PMB
- PYTHEAS
- WEBLIS.

Cilat janë përfitimet nga përdorimi i FOSS?

Krahas kostos së ulët të FOSS, ka dhe shumë arësye përse bibliotekat sot në botë janë duke pranuar FOSS. Disa nga këto janë:

- Siguria,
- Besueshmëria/qendrueshmëria.
- Standarde të hapura dhe pavarësia nga shitësit;
- Zhvillimi i kapaciteteve lokale të softuerit.

Disavantazhet e FOSS

- Kritika kryesore për softuerin me burim të hapur është *mbikeqja* (a do të mbijetojë në të ardhmen?).
- Çelësi i suksesit të FOSS është *komuniteti aktiv* i përdoruesve dhe zhvilluesve.

Sisteme bibliotekare me burim të hapur

- KOHA
- GREENSTONE

Zgjedhja e sistemit të menaxhimit bibliotekar me burim të hapur

Karakteristikat, mundësitë dhe zbatimet

KOHA

www.koha.org

Çfarë është programi KOHA?

- Koha është sistemi i parë i integruar bibliotekar me burim të hapur (ILS).
- Gjithepefshires, i hapur, perdoret në mbare boten në bibliotekat e të gjithë permasave.
- Zhvilluar nga Horowhenua Library Trust, Zelanda e Re
- [illegible]
- Partneret për shpërndarjen dhe promovimin:
  - Horowhenua Library Trust, Zeland e Re
  - Dhe të gjithë ata që e perdorin

Histori

- Filloi në vitin 1999 nga Horowhenua Library Trust (HLT) në Zelandën e Re.
- Koha (në gjuhen Maori do të thotë0 "thurate" dhe është [illegible]
- Shpërndahet nëpërmjet Licenses se Përgjithshme Publike (GPL)
- Menaxhohet aktualisht nga një skuadër e dedikuar e përbërë nga specialistë softuerësh dhe specialistë të teknologjisë se bibliotekave nga i gjithë globi.

Përse Koha?

- ILS i plotë (të gjithë modulet)
- Përmban standardet
- Ndërfaqe të bazuara në Web
- Softuer i lirë
- Jo i kyçur nga shitësi
- Proces zhvillimi aktiv
- Komuniteti vendos për çfarë dëshiron
- Publikime të vazhdueshme të softuerit

Licensa

Licensa: Licensa Publike e Përgjithshme

Zhvilluesi: Horowhenua Library Trust, New Zealand

Sistemi operativ: Linux, Windows, Mac

Modulet funksionalë: Pasurimi

Katalogimi, Qarkullimi, Kontroli i serialeve, OPAC.

Adresa: [illegible]



Koha - veçoritë

OPAC i bazuar në Web,

Ndërfaqe për qarkullimin dhe menazhimin,

Mbeshtet MARC21 dhe UNIMARC,

Z39.50 server,

Online

Rezervimet & Shtyrjet,

Njoftime për vonesat me e-mail.

Si punon Koha?

Baza e të Dhënave

Rrjeti i Bibliotekës

Suporti për KOHA

Pa pagesë

- Dokumentacioni
- Lorumet
- Chat
- Wiki

Me pagesë

- Migrimi i të dhënave
- Hostimi
- Përshtatjet
- Zhvillimi

http://www.koha.org

Koha dhe SMB të pronësuar:

No	Funksionet	Alice	Libsys	New Genlib	Soul	VTLS	Libsuite	Koha
01	Pasurimi	1	1	1	1	1	1	1
02	Katalogimi	1	1	1	1	1	1	1
03	Qarkullimi	1	1	1	1	1	1	1
04	Web/OPAC	1	1	1	1	1	1	1
05	Serialo	1	1	1	1	1	1	1
06	Format Biblio	1	1	1	1	1	1	1
07	Shkëmbim të Dhënash	1	1	1	1	1	1	1
08	Standardo	1	1	1	1	1	1	1
				[illegible]				[illegible]

Përdoruesit e KOHA

Emri	Lloji	website
Antioch University	Akademike	[illegible]
Northland Bible Baptist College	Akademike	https://libcat.nbbc.edu/
Childcare Resource and Research Unit – University of Toronto	Akademike	[illegible]
West Liberty Public Library	Publike	[illegible]
Nelsonville Public Library System (7 library branches	Publike	[illegible]
Horowhenua Library Trust	Publike	[illegible]
Asian School of Business, Trivandrum Kerala	Shkolle	[illegible]

Zgjedhja e programit për ndërtimin e BD

Karakteristikat, mundësitë dhe zbatimet

GREENSTONE

Objekti, qëllimi

- Krijimi i një sistemi menaxhimi për objektet dighitale që do të depozitojë dhe të ruajë ędo lloj burimi në përjetësi;
- Sigurimi i akcesit në këto burime për përdoruesit në përputhje me të drejtat e autorësisë;
- Kthimi i burimeve të paakcesueshme në të akcesueshme;
- Gjetja me lehtësi e materialit;
- Ruajtja dhe promovimi i koleksioneve;
- Përdoruesit do të shfletojnë burimin nëpërmjet aplikimeve bashkëkohore;
- Përdoruesit, kur është e mundur, do të përjetojnë burimin në të njëjtën mënyrë si origjinalin.



Çfarë është programi Greenstone?

- Paketë për ndërtimin, mirëmbajtjen dhe shpërndarjen e koleksioneve digjitale të bibliotekës.
- Gjithepefshires, i hapur;
- Zhvilluar nga Projekti për Bibliotekat Digjitale në University e Waikato në Zelanden e Re,
- Partneret për shpërndarjen dhe promovimin:
  - UNESCO
  - Human Info NGO, Belgium
  - Dhe të gjithë ata që e përdorin, pra
  - Ne!

Çfarë kemi arritur ?

- Ndërtimin e koleksioneve digjitale;
- Zbatimin e metadatave;
- Koleksione plotësisht të kërkueshme;
- Personalizimi i faqes kryesore të bibliotekës digjitale të BK;
- Prezantimi i koleksioneve në WWW.





- Integrimi i katalogëve elektronikë të BK dhe i burimeve të para digjitale në portalin europian tregon që kemi qenë të suksesshëm në zbatimin e standardeve të shkencës bibliotekare në përpunimin e informacionit si dhe në krijimin e Bibliotekës Digjitale Albanologjike (e-ALBANICA).

...Përfundime

- Me gjithë veshtirësitë e shumta, është e nevojshme që bibliotekat tona të marrin iniciativë në bashkëpunim për të qenë qendra të rëndësishme të komunikimit dhe informacionit për komunitetin tonë duke thyer izolimin dhe urinë për informacion

Përfundime…

- Zbatimi i sistemeve bibliotekare me burim të hapur është një mundësi e madhe që nuk duhet humbur për:
  - ndërtimin e katalogut elektronik dhe hedhjen e tij në Internet,
  - krijimin e katalogut përmbledhës,
  - krijimin e objekteve digjitale albanologjike
  - me cilesi të larte, me shpenzime të pakta
- Domosdoshmëria e daljes se katalogëve online, objekteve digjitale si dhe burime elektronike përmes ndërfaqeve grafike dhe shërbimeve www mbi zhvillimin e bibliotekave tona.

Bibliografia dhe albanologjia, vështrim historiko-analitik

Suela NDOJA
Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë

Bibliografia interaktive. Risi të bibliofilisë në Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë

Në kushtet e vjeljes së informacionit mbi librin dhe posaçërisht për bibliografinë apo shkencën e albanologjisë, biblioteka po përballet me një gjeneratë të re studiuesish. Këta vjeljen e informacionit janë të predispozuar ta përmbushin kryesisht nëpërmjet mjeteve të teknologjisë virtuale, metodë kjo që s'mund të shmagë atë tradicionale të kontaktit me librin në Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë, sidomos për Antikuarin dhe Fondin Albanologjik.

Portali i BKSh-së është i mjaftë për ta. Duke parë një largim të studiuesve të rinj nga kontakti me librin është zhvilluar sidomos 5 vitet e fundit me iniciativën e drejtorisë hapja e ekspozitave për ekzemplarët albanologjikë jashtë ambienteve të BKSh-së.

Një nga këto tematika ishte edhe ekspozita antikuare e Bibliotekës së Bushatllinjve me vlera unikale në Europë, ku u morën informacione nga specialistët e BKSh-së, që kishin rolin e ciceronit. Regjistrimi i këtyre informacioneve shtesë nga specialistët e bibliotekës, prej pinjollëve të familjeve të mëdha posedues të bibliotekave private, realizoi një komunikim të drejtëpërdrejtë me bartësit e informacioneve. Kjo është një strategji e BKSh-së. Veçojmë këtu edhe ekspozitën e të Shenjtëve, që kishin kaluar në Shqipëri, gjë që ngjalli interesin e studiuesve të klerit.

Në këtë periudhë, edhe studiuesit e vjetër kanë ulur orët e frekuentimit meqë është krijuar komoditeti që informacioni të merret virtualisht. Por sfida e BKsh-së është me studiuesit e rinj, të cilët duhet të aklimatizohen me tekstet origjinale, sidomos të fushave të paleografisë dhe historisë apo si botimet e reja, që nuk përmbushin kriterin e përpiktë të karaktereve ortografike dhe paxhinimit origjinal.

Një zë të veçantë zënë këtu punimet pasuniversitare, të cilat duhet t'u drejtohen burimeve bibliografike dhe vetë teksteve të shkruara në origjinal, si: latinisht, greqishte e vjetër, venetisht, gjë,

që mund të realizohet vetëm nga BKSh-ja, vetëm nga bibliografia dhe adnotimet e specialistëve tanë. Prandaj ata duhet të bien në kontakt me eksponantet, gjë, që s'është e mundur në të gjitha rastet. Për këtë arsye, duhet përpunuar një strategji e re për ofrimin e këtyre portaleve si shërbime për bibliografitë e albanologjisë, që deri tani janë bërë në mënyra të ndryshme, pra shkurt Diplomanti dhe Doktoranti i sotëm është sfidë e BKSh-së.

Veprimtaria e institucionit tonë po luan funksionin e ungjillizimit të antikuarit albanologjik dhe të monumenteve kulturore, madje jashtë mjediseve të institucionit. Produkt i këtij funksiosni interaktiv me bibliofilët në fushën e historisë dhe të shkencave albanologjike duhet të jenë referencat e përftuara, që të bëhen pjesë e kërkimit dhe përfshirjes në sistem.

Nga premisat e para bibliografike tek "Albanica"

Në Shqipëri shkenca e bibliografisë arriti që të bëhet e tillë pas një periudhe parashkencore, që zgjati deri në hartimin dhe botimin e volumit "Albanica" në vitin 1965, që jep në mënyrë sinkretike disiplinën e standardizuar kronologjikisht të bibliografisë të autorëve më të shënuar të albanologjisë. Ky botim i Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë, hartuar nga Aldo Çoba e Zef Prela, e vunë albanologjinë brenda një strukture bibliografike praktike dhe shkencore, gjë që është inicuar në revistat "Leka" e "Hylli i Dritës" dhe vijuar nga Zef Valentini në Palermo. Ky studiues kishte lënë 5000 faqe dorëshkrim me studime albanologjike në Muzeun e Jezuitëve në Shkodër, arshivuar nga Dr. Injac Ndoja dhe Filip Ndocaj (në fund të viteve '40). Kjo dosje u bë pjesë e Arkivit të Institutit të Shkencave, sot Arkivi i Shtetit.

"Albanica" në botimet e reja, që vijuan, përfshin dyfishin e veprave të përshkruara, duke shtuar gjithashtu harta dhe ilustrime, të cilat nuk ishin përfshirë në botimin e vitit 1965. Kjo punë u drejtua nga Sektori i Albanologjisë pranë BKSh-së. Periudha me të cilën merren dy volumet e "Albanica"-s janë: shek. XV-XVIII (I) dhe 1800-1849 (II), ku përfshihen veprat më të njohura të udhëpërshkruesve, gjeografëve, duke përfshirë këtu edhe historianët antikë. Në këtë bibliografi përshkruhen 627 libra, ekstrakte, fotokopje, harta e ilustrime. Gjuhët kryesore nga është vjelë materiali janë gjuhët: greke, latine, angleze, gjermane, portugeze etj.

Përveç kësaj, albanologjia, në korrelacion me bibliografinë, ka mbushur atë boshllëk që kishte krijuar mungesa e bibliografive të veprave fetare, që nga Kodikët deri te dorëshkrimet, të cilat janë përshkruar në "Albanica", edhe kur nuk kanë qenë të depozituara në BKSh. Tashmë, këto bibliografi kanë dhënë produktin e vet dhe përshkrimi shkencor i bërë për çdo vepër, kodik ose hartë u riformatua në teknologjinë virtuale, duke u bërë pjesë e rrjetit komunikativ të siteve, jo vetëm të qarqeve akademike, por edhe për t'u shfrytëzuar nga përdoruesit kudo, proces i cili ka filluar dhe ecën me shpejtësi.

Burimet tona bibliografike janë baza

e furnizimit me të dhëna të sigurta të markuara BKSh. Sfidë e mëtejshme është digjitimi i fondit albanologjik, duke sjellë kështu risinë më të fundit, që ofron tregu ndërkombëtar. Ky proces ka filluar duke digjituar veprat monumentale të kulturës shqiptare, siç është "Historia e Skënderbeut" e Barletit, për t'u pasuar me të tjera kolana të rëndësishme për kulturën, por, sidomos albanologjinë.

Bibliografia retrospektive me hedhjen e të dhënave për fondin albanologjik të shek. XVIII mund të quhet e përfunduar dhe hyjmë në përshkrimin e bibliografisë korrente të albanologjisë.

Në fund të shek. XIX me revistën "Albania" nisin përpjekjet dhe botimet e para të bibliografisë albanologjike. Kujtojmë pionierët e Rilindjes dhe të shtypit shqiptar, si: Konica, Kristo Dako me radhuan e tij me mbi 180 njësi referenciale të librave të huaj mbi Shqipërinë dhe po aq ekstrakte nga buletinet diplomatike. Vlejnë për t'u shënuar edhe përpjekjet në revistat "Hylli i Dritës" dhe "Leka", përmes rubrikave të veçanta për të dhënë përshkrime dhe adnotime për vepra dhe seri veprash tematike lidhur me historinë, sidomos të lashtë të botës iliro-shqiptare, që e pasuan me serinë "Vepra pijore" të Etër-ve Jezuitë, ku u botuan përkthime të albanologëve, si: Karl Patsch, Kretschmer, të cilët kontribuan direkt në ngritjen e institucioneve kulturore shqiptare.

Në vitet 1954-1955 në revistën "Nëntori", Jup Kastrati boton bibliografinë e autorëve nga viti '45-'55, por, pa përshkrim bibliografik, duke përmendur vetëm njësitë e botimit për autorët e kohës, por duke censuruar në mënyrë joshkencore autorët e dënuar politikisht të kësaj periudhe si Malëshova etj. Në këtë fushë, u angazhua edhe Dhimitër Shuteriqi pas një përvoje që kaloi me botimin "Letërsia e re shqipe" më 1950 dhe vijoi me veprën "Shkrime të vjetra shqipe", ku kriteret bibliografike futen në hulli shkencore.

Shtyrja për një kohë të gjatë, deri në vitin 1998, për botimin e një bibliografie të plotë dhe shkencore, domethënë të vënies në vendin që u takonte Kodikëve, librave dhe hartave, është një haraç që shkenca e bibliografisë shqiptare ia pagoi politikës në fushë të kulturës, por, para së gjithash asaj të shkencës së bibliotekës, pasi e ndau scriptumin në laik dhe fetar, metodë kjo antishkencore, që ka ndikuar drejtëpërsëdrejti në formimin e mangët të studiuesve, historianëve dhe gjeografëve, paleografëve etj.

Tash, me kapërcimin e këtij handikapi, sfida e bibliografisë në suazën e Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë dhe të rrjetit të bibliotekave të Tiranës dhe Prishtinës është sigurimi i ekzemplarëve magjistralë për historinë dhe kombin tonë, për të ndjekur institucionalisht atë që Mithat Frashëri, Kristo Dako, Lef Nosi, Eqrem Vlora e bënin në rrugë private për sigurimin e veprave dhe dorëshkrimeve, që i ndihnin çështjes kombëtare.

Ky kapërcim nga vështrimi introvers në ekstrovers kërkonte disa koordinime drejt bibliotekave dhe antikuaristëve perëndimorë ose të vendeve fqinje për përpilimin e adnotimeve dhe përshkrimeve për ato vepra që nuk mund t'i sigurojmë dot nëpërmjet ankandeve. Një praktikë të tillë e ka zhvilluar në fillimet e veta BKSh-ja, por, që është ndërprerë në

të veprave me burime fetare, por edhe atyre të periudhës së Perandorisë Turke, bibliotekat kombëtare kanë inicuar impaktin me format e reja të përshkrimit dhe paraqitjes së dokumentit libror, qoftë ai në formë libri apo CD. Krijimi i rrjetit virtual të bibliografisë albanologjike mund t'i përshtatet bibliografisë së tregut, domethënë duke hapur një portal shërbimi jopublik për dhënien elektronikisht, duke iu përgjigjur kërkesës gjithmonë në rritje të studimeve albanologjike.

Sfida të tjera janë monografitë bibliografike, ku mund të përfshihen resurse dhe hyrjet më të reja sipas fushave përkatëse që kanë lidhje me albanologjinë dhe që s'mund të mbulohen nga agjenci të tjera.

Për shërbimet e ofruara nga Sektori i Albanologjisë duhet hapur një debat interaktiv me studiuesit për kërkesat e reja, qoftë nga mënyra e publikimit të punëve tona, disponimin ndaj tyre, si dhe arritja e disa standardeve në periodizimin e botimeve bibliografike në suazën e selektimeve të reja. Në këtë kuadër, vijimi i botimit të "Albanica"-s mund të përfshijë skeda leximi e referencash për ato ekzemplarë të cilët nuk mund të ofrohen për hir të vlerës së tyre unikale.

Albanologjia dhe bibliografia në zhvillim

Rimarrjet bibliografike, përsa i përket përpunimit shkencor, përshkrimit bibliografik, adnotimet dhe referencat kërkojnë, në rastin e antikuarëve, një kontakt fizik me këta ekzemplarë. Një pjesë e konsiderueshme e këtyre ekzemplarëve mund të përballojë jo më shumë se dy - tre shfrytëzime, pa u rrezikuar nga shpërbërja. Për këtë arsye, duhet bërë një plan afatgjatë për sigurimin e një kopjeje digjitale përdorimi, për punimet e mëtejshme bibliografike, që sjell koha e re, nëpërmjet monobibliografive sipas tematikave specifike dhe që përfshin një seri botimesh.

P.sh. në fushën e historisë citimet toponimike në kohën e Bizantit ose për disa bibliografi të tregut shfaqin interes hartat dhe të dhënat për ekonominë në periudha të caktuara, gjë që i ka bërë të tilla botime mjaft të kërkuara. Për këtë arsye BKSh-ja i ka paraprirë me përshkrimin e të gjitha hartave me karakter albanologjik dhe së shpejti ky informacion do të hidhet edhe në Internet, duke iu përshtatur kështu nevojave të lexuesve, dhe sidomos kategorisë së studiuesve dhe historianëve.

Në këtë kohë të ekonomisë së tregut, BKSh mund të realizojë shumë shërbime për vetë asetet profesionale dhe me mbi 20000 tituj që ajo pason dhe i ka të përpunuara shkencërisht.

Përveç bashkëpunimit me botuesit, BKSh mund të ofrojë edhe bibliografi tipologjike për institucionet e larta, si: Fakulteti i Filologjisë, Akademia e Shkencave, Qendra e Studimeve Albanologjike etj. për vetë karakterin e punës me projekte që zhvillohet në këto institucione.

Si përfundim, mund të themi se është i vetmi institucion që mund të marrë përsipër, jo vetëm standardizimin e vetvetes, por edhe të ndikojë në përhapjen e frymës standardizuese, sidomos të shkencës së albanologjisë. Shembull i saj është pozicioni lider i botimit special të BKSh-së, revista "Bibliothecae", që i

vitin 1950, kohë kur Biblioteka u lidh me rrjetin e bibliotekave të botës lindore dhe mjetet financiare u zëvendësuan me huazimin.

Sigurimi i këtyre adnotimeve dhe Kodikëve, që kanë pasë vend origjine Shqipërinë, por, tashmë janë pronë e arkivave, mund të bëhen pjesë e "Albanica"-s në ribotime të ardhshme.

Pas themelimit të bibliografisë shkencore, heqjes së censurës, daljes në dritë përmbush të gjitha parametrat një reviste shkencore dhe unikale në Shqipëri, që ofron edhe imazhin e markës BKSh imazh, i cili mund të marrë përsipër edhe standardizimin në fushën e periodikëve gjysëmshkencorë, që qarkullojnë në territorin tonë. Ka ardhur koha, që të tillë periodikë, të markohen dhe të sigurojnë një kontroll bibliografik duke kontribuar për një aset kombëtar, siç është albanologjia.

Bibliotekat e veçanta dhe botimet albanologjike

Flamur MALOKU
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

Hyrje

Tema "Bibliotekat e veçanta dhe botimet albanologjike", është formulim që i përshtatet bindshëm informacionit, evidencës rreth temës bazë së kësaj konference. Kështu, ndjekja e kësaj procedure përcakton tashmë vetë modelin e kërkimit. Kërkimet, evidencat, skemat nuk mbyllen asnjëherë, ato lihen të hapura përherë edhe atëherë kur në pyetje janë evidencat statistike. Duke qenë kjo hyrja, tema e përcaktuar së paku pretendon të zgjedh nyje mbi informimin e botimeve albanologjike në kuadrin e bibliotekave të veçanta. Andaj, tema e përzgjedhur mbështetet në idenë e informacionit si rezultat i brendshëm kërkimi duke esencializuar para së gjithash specifikën e fondeve albanologjike në kuadrin e bibliotekave të veçanta.

Përkufizim

Bibliotekat e veçanta kanë një fond të veçantë të librave, në të cilat gjendet literatura bazë e institucionit përkatës. Këto biblioteka kryesisht përmbajnë literaturë profesionale, duke u nisur nga monografitë, enciklopeditë, serialet e ndryshme, të cilat janë në gjuhën e vendit dhe në gjuhët e huaja. Sipas enciklopedisë "Enciklopedica Britanica", bibliotekat speciale janë ato biblioteka, ku ka koleksione të veçanta të librave, të cilat u nevojiten një grupi të caktuar të përdoruesve.[1]

Objektivi kryesor i bibliotekave të veçanta është që përdoruesit e tyre të kenë në dispozicion materialet dhe informacionet e tanishme, por edhe informacion nga retrospektiva, çdo herë në përputhje me profilet e tyre të interesimit. Shfrytëzuesit e këtyre bibliotekave janë punonjësit profesionalë të institucionit

[1] *http://www.britannica.com*

përkatës, apo të ndonjë organizate përkatëse.

Historiku i bibliotekave të veçanta në Kosovë

Formimi i rrjetit të bibliotekave speciale në Kosovë fillon më 1946. Këtë vit "Komiteti Shqiptar i Rrethit të Prizrenit" vendosi që të ngrihej një ndërtesë në kuvendin ku ishte mbajtur Lidhja e Prizrenit dhe atje të hapej Biblioteka e Komitetit Shqiptar të Kosovës. Në fillim biblioteka kishte rreth 200 libra, kryesisht broshura e ndonjë gazetë e revistë, si: "Lirija", "Rilindja", "Përparimi".

Gjatë periudhës 1946-1956 formohen rreth tridhjetë biblioteka të veçanta (profesionale e të përgjithshme shkencore), siç është ajo e Institutit Albanologjik të Prishtinës. Deri në vitin 1967, formohen edhe 15 biblioteka të veçanta si ajo e Institutit të Historisë të Prishtinës, Muzeut Kombëtar (Krahinor), e Shtëpisë Gazetare-Botuese "Rilindja", Biblioteka e Radio Prishtinës etj. Sipas Tahir Foniqit, përafërsisht deri në vitin 1986 në Kosovë kanë qenë 55 biblioteka speciale me 87900 njësi: libra e periodikë.

Pas vitit 1986, këto të dhëna lëvizin dukshëm, ngase në Kosovë në masë të madhe fillon represioni i atëhershëm serb, ku edhe mbyllen shumë institucione, gjë që pasohet me mbylljen edhe të bibliotekave të veçanta.

Kjo gjendje vazhdon deri në luftën e fundit në Kosovë në vitin 1999. Mirëpo, edhe pas luftës së fundit, bibliotekat e veçanta i përcjellë një fat i keq, ngase rrjeti i këtyre bibliotekave nuk është zhvilluar paralel me numrin e institucioneve në Kosovë. Shumë institucione, organizata të ndryshme, tashmë funksionojnë pa bibliotekat e tyre. Ajo çka na intereson këtu më së shumti janë ato institucione që kanë kontribuar për fondin albanologjik. Prandaj, gjatë hulumtimit, jemi ndalur vetëm në tri institucione të rëndësishme, si: Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës (ASHAK), Instituti Albanologjik i Prishtinës dhe Arkivi i Kosovës, ku në këto institucione, fondi i albanologjisë është më i madh në raport me fondet e tjera, pasuruar me botime, dhurata, këmbim botimesh me shtëpi botuese etj. Të gjitha botimet albanologjike të punëtorëve shkencorë të këtyre institucioneve paraqesin kontribut me vlera shkencore nga albanologjia.

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës (ASHAK)

Që nga themelimi i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (ASHAK) në vitin 1978 e deri në vitin 2010, koleksioni i studimeve albanologjike numëron përafërsisht 500 njësi, libra në gjuhën shqipe, por edhe në gjuhët e huaja, si në atë serbo-kroate, angleze, gjermane, që i përkasin fushës së dijes albanologjike.

Rrethanat nëpër të cilat kishte kaluar Kosova përballë pushtuesit serb, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, u bë zë i fuqishëm kundër zhbërjes nga serbët, gjë që ndikojë negativisht për veprimtarinë shkencore të akademisë; në veçanti ndikoi shumë në studimet albanologjike, e cila njëherësh ka bërë që të ketë edhe ngecje në botimet e

koleksioneve të ndryshme albanologjike. Në vitin 1989, regjimi i atëhershëm serb, fillon të mbushë bibliotekën e akademisë me botime serbe. Masat represive serbe çuan deri në ndalimin e plotë të botimeve shkencore-albanologjike. Literatura e sjellë nga regjimi i atëhershme serb dhe botimet që bëheshin ishin kryesisht literaturë propagandistike, aspak shkencore. Mirëpo, pavarësisht rrethanave të kohës, të cilat i përjetoi ky institucion i dijes, ASHAK e zhvilloi veprimtarinë shkencore, ku janë botuar shumë libra të një rëndësie të veçantë për albanologjinë.

Akademia u përqendrua kryesisht në botimet nga gjuhësia, ku si preokupim kryesor i kishte botimet që kishin të bënin rreth origjinës së gjuhës shqipe dhe vendit të formimit të saj, rreth raporteve të shqipes më gjuhët simotra indoeuropiane, rreth interferencave gjuhësore midis gjuhëve të Ballkanit etj. Duke qenë kjo edhe kërkesë, akademia boton veprat e albanologëve të shquar, si: Çabej, Ajeti, Riza dhe të albanologëve të huaj. Ky sistem konceptual-metodologjik e programatik i botimeve nga akademia, mundësoi të zhvillohet më tej veprimtaria hulumtuese, shkencore rreth shumë problemeve të rëndësishëm e aktual, siç ishte ai i origjinës së popullit shqiptar, i gjuhës së tij.

Sa për ilustrim e informim përzgjedhim disa nga tituj që janë botuar nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës: Eqrem Çabej "Studime shqiptare të zgjedhura" (2008); Eqrem Çabej "Hyrje në historinë e Gjuhës Shqipe, Fonetika historike e Shqipes," (1960); Pjetër Bogdani "Çeta e profetëve" (2005); Selman Riza, "Vepra" 1,2 (1996); Gazmend Zajmi, "Vepra"1 (1997); Idriz Ajeti "Vepra-1,2,3,4,5" (1997); Besim Bokshi, "Pjesorja e shqipes" (1998), që përmban zhvillimin historik të gjuhës së folur dhe të shkruar shqipe; Ibrahim Rugova, "Kritika" (2007); Rexhep Qosja, "Prej letërsisë romantike deri te letërsia moderne" (2006); Sabri Hamiti, "Tematologjia", (2005), "Albanizma" (2009); Rexhep Ismajli, "Pasionet dhe pësimet e Selman Rizës" (2009); si edhe revista "Studimi" etj. Këto botime nga albanologjia hapën rrugët që të shqyrtonin shumë çështjeve nga fusha e albanologjisë, duke shtuar teza e teori të reja për vetë dijen albanologjike.

Në kuadrin e shumë botimeve të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, është më rëndësi të theksohen edhe botimet e albanologëve të huaj në gjuhën shqipe, të cilët kanë kontribuar në identifikimin e shumë çështjeve komplekse që kanë të bëjnë me gjuhën shqipe dhe me historikun e saj, p.sh.: amerikani Eric P. Hamp, "Studime krahasuese për shqipen" (2007); Vasllav Kimohovski, "Për shqipen" (2004); Holger Pedersen, "Studime për gjuhën shqipe" (2003). Punët kërkimore të albanologëve të huaj janë të rëndësishme për dijen dhe kulturën shqiptare. Këta albanologë ishin njohës të jashtëzakonshëm të fushës së gjuhëve indoeuropiane, njohës të zhvillimeve në fushën albanologjike. Kontributet e tyre shtrihen thellë nga arkigjeneza e deri në fushën e zhvillimit të strukturës gramatikore të shqipes.

H. Pedersen / V. Kimohovski

Gjuha shqipe sipas albanologut H. Pedersen, shihet se ka një sistem të vetin, me një strukturë të harmonishme e origjinale, që përbëhet në radhë të parë nga elemente që janë të përbashkëta për të dy dialektet. Krahas tyre, ajo përfshin, në përpjesëtime të ndryshme, edhe elementë të veçantë, që janë tipare dalluese të gjuhës shqipe karshi gjuhëve të tjera. Një hetim i tillë vihet re në fushën e fonetikës, të morfologjisë të formimit të fjalëve etj. Ai i hulumtoi çështjet e gjuhës shqipe nga brenda e nga jashtë, studioi historinë e brendshme dhe të jashtme të shqipes, duke gjurmuar në të gjitha dimensionet dhe në të gjitha rrafshet relevante me qëllim ndriçimi të çështjeve të shqipes. Gjithashtu, edhe albanologu Vasllav Kimohovski, përmes kërkimeve, përpiqet të japë një provë më shumë për prejardhjen e gjuhës shqipe, duke u mbështetur e tërhequr paralele karshi gjuhëve të tjera. Ai thotë se "sistemi nominal i gjuhës shqipe zë një vend qendror në gjuhësinë ballkanike qysh në fillimet e kësaj shkence. Gadishulli ballkanik është një zgjedhje konvergjente dhe gjuha shqipe është lidhur me të".

Instituti Albanologjik i Prishtinës

Instituti Albanologjik i Prishtinës, që nga themelimi e deri në vitin 1953 është institucion i pavarur kërkimor shkencor, që merret me studimet albanologjike, me kulturën shpirtërore e materiale të shqiptarëve. Ai lindi si nevojë imediate për fushën e albanologjisë për të plotësuar kërkesën e domosdoshme të kohës.

Gjatë viteve të ekzistencës, Biblioteka e Institutit Albanologjik të Prishtinës është pasuruar me materiale të ndryshme me botime albanologjike nga të gjitha fushat, që mbulojnë këtë institut.

Përgjithësisht, puna kërkimore e albanologëve të këtij institucioni shënon empirizmin në dije-mendim, gjë që kurorëzohet me botime të veçanta nga fusha e albanologjisë. Vetëm në vitet '70-'80 botohen përafërsisht mbi 195 njësi, libra nga albanologjia. Ndërsa në vitet '90 botohen mbi 88 njësi. Në kuadrin e këtyre botimeve është me rëndësi botimi i revistës shkencore-albanologjike "Gjurmime albanologjike", e cila tash në vitin 2010 arrin numrin 120-të të botimit. Koleksionet albanologjike gjithnjë shtohen, sidomos në dekenien e fundit, ku Instituti Albanologjik boton përafërsisht '90 njësi.

"Nga fusha e albanologjisë do të synohet të botohen vepra përgjithësuese, që pasqyrojnë prurjet e reja në gjuhën shqipe, studime të mikromjediseve shoqërore si rezultat i përvetësimit të gjuhës shqipe në bashkësi folësish me lëvizje demografike." Rëndësi të veçantë do t'i kushtohet pasurisë leksikore të shqipes, fjalorëve të tipeve të ndryshme që do të japin prurje të veçanta të kësaj pasurie, si dhe studimeve në fushën e etnokulturës.

Botimet

Frang Bardhi, "Fjalor Latinisht-Shqip, 1635" (1983); Aristoteli, "Poetika", (1984); Aleksandër Stipçeviç, "Interpretime Albanologjike", (1994); Rexhep Qosja "Nocione albanologjike" (1983); Isak Shema, Ibrahim Rugova, "Bibliografi e kritikës letrare shqiptare 1944-1974", (1976); Pajazit Nushi, "Sistemi i grafisë së tingujve të shqipes dhe vetitë perceptive e përmasat e lexueshmërisë së shkronjave të alfabetit të gjuhës shqipe" (1988); Abdullah Zajmi, "Përpjekjet e rilindësve për një alfabet të përbashkët të shqipes", (1970); Ibrahim Rugova, "Kahe dhe premise të kritikës letrare shqipe" (1986); Tafil Kelmendi, "Kështjella e sintaksës", (2006); Zymer Neziri, "Studime për foklorin I-II", (2006); Rrustem Berisha, "Komunikime artistike të këngës popullore", (2006).

Të gjitha botimet e Institutit Albanologjik të Prishtinës do të realizohen në kuadrin e programit, që do t'i shërbejnë zhvillimit të mëtejshëm të shkencës albanologjike duke i dhënë opinionit shkencor të brendshëm dhe të jashtëm vepra themelore për historinë, gjuhën, kulturën dhe traditat, si dhe problemet aktuale sociale të popullit shqiptar, të cilat, veç të tjerave, do të ndihmojnë për afirmimin e vlerave dhe të trashëgimit të tij historik, si dëshmi e identitetit kombëtar të shqiptarëve si popull. Nëpërmjet studimeve, synohet të ndriçohen aspekte thelbësore të periudhave të ndryshme nga fusha e albanologjisë, në mënyrë që të vihen në qarkullim shumë mendime shkencore të panjohura, me rëndësi për trajtime të reja dhe objektive të çështjeve albanologjike. Studime të tilla, si dhe baza e gjerë e botimeve, do të shërbejnë shumë për avancimin e studimeve albanologjike në përgjithësi.

Në kushtet e sotme të zhvillimeve botërore, realizimi i këtyre studimeve albanologjike ka rëndësi për ruajtjen e veçorive kombëtare si shprehje e diversitetit të kulturave e qytetërimeve, si pjesë e pasurisë universale të kulturës së njerëzimit.

Dokumente të rëndësishme për albanologjinë në Arkivin e Kosovës

Arkivi Shtetëror i Kosovës nuk është institucion botues, sikurse Akademia dhe Instituti Albanologjik, por në të gjenden dokumente me rëndësi vitale për albanologjinë.

Në Arkiv, që nga themelimi i tij në vitin 1951, funksionon edhe biblioteka e tij e veçantë. Aty kryesisht ka literatu-rë profesionale dhe shkencore nga albanologjia, historia, arkivistika etj. Mirëpo, ka edhe revista shkencore, fjalorë, leksikonë, enciklopedi etj. Në këtë bibliotekë ka të dhëna edhe për zhvillimin e shkencës së albanologjisë, kryesisht artikuj të botuar në revista të ndryshme, si ato të botuara në Kosovë. Ka edhe disa revista të vjetra të botuara në Beograd nga Fakulteti Filozofik, Katedra e Albanologjisë. Me rëndësi të posaçme për studimet albanalogjike janë dokumentet arkivore që ruhen në fondet dhe koleksionet e veçanta të Arkivit Shtetëror të Kosovës. Dokumente me rëndësi janë ato për alfabetin shqip të Kongresit të Manastirit,

të shoqërive të shumta, që kanë vepruar në Bullgari, Rumani, Egjipt, Amerikë, Turqi, Greqi, Austri etj.

Në Arkivin e Kosovës gjenden shumë dokumente të shek. XIX, të cilat janë hulumtuar në Arkivin Shtetëror të Vjenës, ku ka shumë të dhëna për alfabetin shqip. Gjithashtu, në të ka dokumente të rëndësishme që janë gjetur në Arkivin Shtetëror të Bosnjës, siç është një abetare e gjuhës shqipe e vitit 1898. Po ashtu, ka edhe dokumente të tjera. Këto dhe shumë të tjera janë fotokopjuar dhe janë arkivuar në Arkivin Shtetëror të Kosovës.

LITERATURA

1. FONIQI, Tahir, *Tipat e bibliotekave në Kosovë 1944-1986,* Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, Prishtinë 2008.
2. FONIQI, Tahir, *Tema nga bibliotekaria,* Era, Prishtinë, 2003.

- REZOLUTË

Shkenca e bibliotekave dhe albanologjia 73

REZOLUTË

Shkenca e bibliotekave dhe albanologjia

Më 22 - 23 nëntor 2010 u mbajt edicioni i pestë me temë *Shkenca e bibliotekave dhe albanologjia* i Konferencës Kombëtare të Bibliotekonomisë, si institucion kulturor-shkencor i përbashkët Shqipëri-Kosovë.

Konferenca u organizua në mjediset e Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë. Ajo trajtoi gjerësisht dhe me profesionalizëm problematika që lidhen me funksionet dhe detyrat e bibliotekave kombëtare të Shqipërisë dhe të Kosovës në fushën e grumbullimit, përpunimit dhe shërbimit të informacionit albanologjik, si pjesë e rëndësishme e përpjekjeve shkencore për afirmimin e identitetit kombëtar të shqiptarëve, të historisë dhe të kulturës së tyre.

Drejtues dhe specialistë të të dy bibliotekave paraqitën ligjërata dhe kumtesa, në të cilat analizoheshin praktikat, por dhe vizionet e përbashkëta për rolin që luajnë në epokën digjitale bibliotekat kombëtare përkatëse në një fushë të rëndësishme të veprimtarisë së tyre si menaxhimi i burimeve të dijes albanologjike.

Më konkretisht, në konferencë u trajtuan probleme të ndryshme që kishin të bënin me formimin e specialistëve të burimeve albanologjike në të dy bibliotekat tona kombëtare, me funksionet albanologjike të këtyre bibliotekave, zhvillimin e koleksioneve albanologjike në mjedisin digjital, rëndësinë e koleksioneve të hartografisë për albanologjinë, domosdoshmërinë e sistemeve bibliotekare elektronike me burim të hapur, raportet e bibliografisë me albanologjinë në vështrim historiko-analitik, bibliotekat kombëtare dhe komunikimin albanologjik, koleksionet e studimeve albanologjike, format e pasurimit në albanologji, bibliotekat e veçanta dhe botimet albanologjike etj.

Kumtesat e mbajtura u përqendruan në rolin ndërmjetës, por tejet të rëndësishëm, të të dy bibliotekave midis dijeve albanologjike që bartin koleksionet e tyre dhe përdoruesve që i shfrytëzojnë ato, që në këtë rast janë kryesisht lëvrues të shkencave

që përbëjnë albanologjinë. Ky pozicion i kahershëm dhe tradicional i bibliotekave kombëtare u trajtua vështruar në kushtet e reja të shoqërisë së informacionit dhe të komunikimit dhe në përputhje me kërkesat specifike të përdoruesve të burimeve albanologjike.

Nisur nga situata konkrete e veprimtarisë në funksion të përpunimit dhe shërbimit të informacionit albanologjik në bibliotekat tona, pjesëmarrësit në konferencë miratojnë rezolutën e mëposhtme:

Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë dhe Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës realizojnë me sukses detyrat funksionale që lidhen me rolin e tyre si ndërmjetëse mes dijes albanologjike dhe informacionit që bartin në koleksionet gjegjëse, nga njëra anë, dhe lexuesit që i përdor ato, nga ana tjetër. Megjithatë, bibliotekat kombëtare të Shqipërisë dhe Kosovës prej kohësh ndiejnë si domosdoshmëri thellimin dhe përmirësimin e veprimtarisë së tyre që ka të bëjë me plotësimin e kësaj detyre themelore, sidomos në kushtet e shoqërisë së informacionit dhe të teknologjive të reja.

Konferenca thekson rëndësinë e një pozicionimi të qartë, të saktë dhe sa më profesional të dy bibliotekave tona në përmbushjen e detyrave dhe funksioneve të tyre albanologjike. Krahas përpjekjeve për integrimin e bibliotekave të Shqipërisë dhe Kosovës në rrjedhat bashkëkohore europiane dhe botërore, bibliotekarët shqiptarë të të dy vendeve duhet të rritin rolin e tyre në mbështetje të zhvillimit të shkencave albanologjike dhe të vlerësojnë maksimalisht informacionin, sidomos atë elektronik, për veprat albanologjike që ruajnë në fondet e tyre.

Më tepër se deri më sot bibliotekat tona duhet të vlerësojnë teknologjitë e informacionit duke i konsideruar ato si mjete të rëndësishme për rritjen e efektivitetit të shërbimeve ndaj përdoruesve, përfshirë edhe shkencëtarët dhe studiuesit albanologë. Sistemet e integruara bibliotekare të të dy bibliotekave mundësojnë bashkëpunim të frytshëm mes tyre, sidomos në dhënien dhe marrjen e informacionit bibliografik të karakterit albanologjik, ndaj, në kuadër të bashkëpunimit në veprimtarinë informuese bibliografike dhe të krijimit të bazave të të dhënave, konferenca e sheh të udhës krijimin e një portali të përbashkët Shqipëri - Kosovë që do të ofronte informacion albanologjik apo objekte të digjituara, çfarë do të krijonte më shumë mundësi për shkëmbimin e informacionit dhe përdorim të përbashkët të burimeve. U theksua që për realizimin e kësaj ideje është e domosdoshme mbështetja e organeve vendimmarrëse në të dy vendet.

Konferenca ka besim se Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë dhe Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës si edhe bibliotekat e tjera në të dy vendet që shërbejnë literaturë albanologjike do të ngrenë në një nivel më të lartë angazhimin për plotësimin si duhet të detyrave në një fushë të rëndësishme si ajo e shërbimeve albanologjike duke përmbushur kështu misionin e tyre të rëndësishëm kombëtar dhe kulturor.

Tiranë, më 23 nëntor 2010

BIBLIOTHECAE

BIBLIOTEKONOMI PROJEKTE TË REJA DOKUMENTE LEXIME TË REKOMANDUARA HISTORI E LIBRIT DHE E SHTYPIT